



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.93**

**12 korrik**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 434 datë 23.6.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	3807
Ligj nr.10 435 datë 23.6.2011	Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë....	3816
Ligj nr.10 436 datë 28.6.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për reduktimin e mëtejshëm të çlirimit të squfurit” të konventës “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në rreze të gjatë”, 1979.....	3821
Ligj nr.10 437 datë 28.6.2011	Për ratifikimin e marrëveshjes “Për krijimin e Akademisë Ndërkombëtare Antikorrupsion, si organizatë ndërkombëtare”...	3840

**LIGJ**  
**Nr.10 434, datë 23.6.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8872, DATË 29.3.2002 “PËR ARSIMIN  
DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Sistemi i arsimit dhe formimit profesional” (më poshtë AFP) është sistemi që përfshin të gjitha llojet e institucioneve që mbështesin dhe ofrojnë të gjitha llojet e programeve të arsimit dhe kurseve të formimit, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve për nivelet 2, 3, 4 dhe 5.

b) “Të nxënit formal në AFP” është të nxënit që kryhet në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar, të tilla si: institucionet e arsimit të lartë, shkollat, qendrat e formimit ose në punë dhe që është hartuar qartë si formë mësimore, në lidhje me objektivat, kohën dhe burimet. Të nxënit formal është i qëllimshëm dhe i planifikuar nga nxënësi, kursanti apo studenti. Përfundimi i këtij të nxëni certifikohet;

c) “Të nxënit joformal në AFP” është të nxënit, i përfshirë në veprimtari të planifikuara, jo domosdoshmërisht të hartuara si forma mësimore, në lidhje me objektivat, kohën mësimore ose mbështetjen mësimore, por që përmban elemente të rëndësishme mësimore. Të nxënit joformal është i qëllimshëm, i planifikuar nga nxënësit, kursantët apo studentët, i cili, në përgjithësi, nuk certifikohet, por, në raste të veçanta, mund të certifikohet;

ç) “Të nxënit informal në AFP” është të nxënit, i cili përfitohet nga veprimtari të përditshme, që kanë lidhje me punën, familjen ose kohën e lirë. Ky lloj të nxëni nuk është i strukturuar dhe i organizuar për sa u përket objektivave, kohës apo mbështetjes mësimore. Në shumicën e rasteve, të nxënit informal është i paqëllimshëm, i paplanifikuar nga individi që nxë, si rregull, nuk certifikohet;

d) “Të nxënit gjatë gjithë jetës” përfshin të gjitha veprimtaritë e të nxënit, të ndërmarra gjatë gjithë jetës për zhvillimin e aftësive dhe arritjen e një kualifikimi;

dh) “Institucionet mbështetëse të AFP-së” janë institucionet publike dhe private, të cilat mbështesin arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;

e) “Institucionet ofruese të AFP-së” janë institucione publike dhe private, të cilat ofrojnë programe dhe/ose kurse të AFP-së në Republikën e Shqipërisë;

ë) “Qendrat e formimit profesional” janë institucione publike ose private, të cilat ofrojnë kurse të formimit profesional për kursantët;

f) “Qendrat shumëfunktionale ofruese të AFP-së” janë institucione, publike dhe private, që ofrojnë arsimin profesional me nivele të ndryshme dhe kurse të formimit profesional;

g) “Shoqëri tregtare” është personi juridik, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

gj) “Nxënës” është personi, i cili merr arsim në sistemin formal, joformal dhe informal të arsimit;

h) “Kursant” është personi, i cili merr formim në sistemin formal, joformal dhe informal të formimit.

i) “Mësues” është personi i kualifikuar me aftësi pedagogjike e profesionale dhe që angazhohet në AFP, kryesisht për trajtimin e aspekteve teorike të procesit mësimor;

j) “Instruktor” është personi i kualifikuar me aftësi pedagogjike e profesionale dhe që angazhohet në AFP, kryesisht për trajtimin e aspekteve praktike të procesit mësimor;

k) “Partnerë socialë” janë organizatat që përfaqësojnë interesat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, të cilat marrin pjesë dhe kontribuojnë në sistemin e AFP-së;

l) “Partnerë të tjerë” janë organizatat jofitimprurëse, komunitetet e ndryshme, që marrin pjesë në sistemin e AFP-së dhe, së bashku me institucionet administrative shtetërore, punojnë për zbatimin e këtij ligji;

ll) “Certifikatat” (dëshmitë) e llojeve të ndryshme janë dokumente zyrtare që vërtetojnë përmbushjen, nga ana e nxënësve dhe kursantëve, të arritjeve të programeve të akredituara të AFP-së;

m) “Kualifikimi” është specifikimi i standardeve në njohuri, aftësi dhe kompetenca të gjera, hartuar për të përmbushur një qëllim të caktuar, që i është njohur vlefshmëria ose është njohur zyrtarisht për këtë qëllim. Dhënia e kualifikimit për një individ nënkupton që njohuritë dhe aftësitë e këtij individ kanë vlerë në tregun e punës dhe në arsimimin e formimit e mëtejshëm të tij. Kualifikimi jepet, kur një organ kompetent përcakton, nëpërmjet një procesi vlerësimi të sigurisë së cilësisë, se individ i ka arritur standardet e specifikuar;

n) “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”, më poshtë KSHK, është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënimit të përfutur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve, që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile;

nj) “Forma e dyfishtë” është një lloj i ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, i cili kombinon arsimin dhe formimin në një institucion të AFP-së me punën dhe aftësimin praktik në një shoqëri tregtare, nëpërmjet përcaktimeve të një marrëveshjeje midis pjesëmarrësit, institucionit të AFP-së dhe shoqërisë tregtare;

o) “Akreditimi i kurseve dhe i programeve të AFP-së” është procesi i certifikimit të kompetencës apo besueshmërisë dhe njohjes së certifikatave që përmbajnë edhe kreditet e fituara;

p) “Licencim” është akti juridik që i njeh institucionit ofrues të AFP-së të drejtën të ofrojë llojin e veprimtarisë, sipas kushteve dhe kërkesave të paracaktuara;

q) “Njohja e të nxënimit të mëparshëm” informal dhe formal është procesi, me anë të të cilit kompetencat e mëparshme të një personi, të fituara në sistemin informal dhe joformal, mund të merren parasysh përmes një vlerësimi që çon në dhënien e një certifikate të kualifikimit formal;

r) “Arsimi pas së mesmes” përfaqëson një nivel arsimor, që u ofrohet nxënësve që kanë përfunduar arsimin e mesëm, por me programe studimi të nivelit jouniversitar.”.

## Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a” fjala “nxënësit” zëvendësohet me fjalën “personat”.
2. Në shkronjën “b” fjalët “mosha 18” zëvendësohen me fjalët “mosha 16”.
3. Në shkronjën “c” fjalët “personat nën 18 vjeç” hiqen.

## Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 6

#### **Llojet, nivelet dhe kohëzgjatja e arsimit dhe formimit profesional**

AFP-ja përbëhet nga:

a) arsimi profesional publik dhe privat, që fillon pas përfundimit të arsimit bazë, ofrohet në shkollat profesionale dhe është me kohëzgjatje 2-4-vjeçare. Sistemi i arsimit profesional ofron nivelet e mëposhtme të arsimimit:

i) arsim profesional bazë i nivelit I, i orientuar sipas drejtimeve të gjera profesionale, me kohëzgjatje 2 vite shkollore pas përfundimit të arsimit bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë të përgatitjes bazë profesionale dhe lejon kalimin në nivelin II të arsimit profesional ose në tregun e punës;

ii) arsim profesional i nivelit II, i orientuar sipas profileve profesionale për çdo drejtim profesional, me kohëzgjatje 1 vit shkollor pas përfundimit të arsimit profesional bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë të përgatitjes profesionale dhe lejon kalimin në nivelin III të arsimit profesional ose në tregun e punës;

iii) arsim i mesëm profesional, teknik/menaxherial, i nivelit III, i orientuar sipas profileve profesionale, me kohëzgjatje 1 vit shkollor pas përfundimit të nivelit II (struktura 2+1+1) ose 2 vite shkollore pas përfundimit të nivelit I (struktura 2+2), të arsimit profesional. Në raste të veçanta, ka kohëzgjatje 4 vite pas përfundimit të arsimit bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatën e teknikut/menaxherit në profesionin përkatës, si dhe me diplomën e maturës shtetërore profesionale, dhe lejon kalimin në tregun e punës dhe në arsimin tretësor;

b) arsimit profesional pas së mesmes (jouniversitar), publik dhe privat, me kohëzgjatje 1-2 vite shkollore, fillon pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional (niveli III) ose të gjimnazit. Në përfundim të tij ofrohet certifikatë e kualifikimit profesional në profesionin përkatës dhe mundësohet kalimi në tregun e punës. Kur zgjat dy vite shkollore dhe grumbullon 120 kredite europiane (ECTS), përfundon me marrjen e diplomës “Diplomë profesionale ...” në fushën e arsimit të kryer. Kjo diplomë mundëson kalimin në tregun e punës, si dhe transferimin e krediteve në studimet universitare të ciklit të parë në fushën e arsimit profesional përkatës;

c) formimi profesional, publik dhe privat, fillon pas përfundimit të arsimit bazë, ofrohet në qendrat e formimit profesional dhe zgjat deri në 2 vite shkollore. Formimi profesional realizohet nëpërmjet kurseve të formimit, të riformimit, si dhe të kurseve-urë të riaftësimit profesional, në mbështetje të rihyrjes dhe të kalimit nga një profesion në një tjetër. Formimi profesional ofron certifikata të kualifikimit profesional.

ç) arsimit dhe formimi profesional në formë të dyfishtë, i cili kombinon arsimimin dhe formimin profesional në shkollë/qendër (për pjesën teorike) me punën dhe aftësitë praktike në shoqëri (për pjesën praktike), nëpërmjet përcaktimeve të një marrëveshjeje midis pjesëmarrësit, institucionit të AFP-së dhe shoqërisë;

d) lloje të tjera të AFP-së, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 4

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) Shkollat profesionale, publike dhe private, të cilat mund të ofrojnë të gjitha llojet dhe nivelet e arsimit profesional parauniversitar. Këto shkolla realizojnë përgatitjen profesionale me karakter të theksuar praktik dhe u japin nxënësve njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale.

b) Qendrat shumëfunktionale, publike dhe private, të cilat mund të ofrojnë të gjitha llojet dhe nivelet e arsimit profesional parauniversitar, si dhe kurse të formimit profesional për të rritur, në po ato drejtime ku ofrojnë dhe arsimimin profesional.

c) Qendrat e formimit profesional, publike dhe private, të cilat mund të ofrojnë kurse të ndryshme të formimit profesional (formim, riformim dhe riaftësim profesional), për fitimin e aftësive të nevojshme profesionale për t’iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.”.

2. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) Institucionet e tjera, publike dhe private, përfshirë institucionet e arsimit të përgjithshëm dhe të lartë.”.

#### Neni 5

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

**Bordi i institucioneve publike ofruese të AFP-së**

1. Bordi i institucioneve publike ofruese të AFP-së (më poshtë Bordi), është organ kolegjal, që përfaqëson interesat e nxënësve/kursantëve, të komunitetit të biznesit, të partnerëve socialë, si dhe të pushtetit vendor. Bordi mbështet institucionin në zhvillimin e profilit të tij në tregun e AFP-së, të lidhur ngushtë me tregun e punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbikëqyr veprimtarinë që lidhet me drejtimin dhe administrimin ekonomik, financiar dhe të pronave të institucionit.

2. Bordi përbëhet nga:

- a) dy përfaqësues të sektorit privat, që lidhet me profilin e institucionit të AFP-së;
- b) një përfaqësues i drejtorisë arsimore, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (për shkollat publike profesionale);
- c) një përfaqësues i këshillit të qarkut, që mbulon institucionin arsimor publik ofrues të AFP-së;
- ç) një përfaqësues i zyrës rajonale/vendore të punësimit, që mbulon institucionin arsimor publik ofrues të AFP-së;
- d) një përfaqësues i personelit mësimdhënës të institucionit publik, ofrues të AFP-së;
- dh) një përfaqësues i nxënësve për shkollat publike të arsimit profesional ose një përfaqësues i punëmarrësve për qendrat publike të formimit profesional.

3. Bordi zgjedh kryetarin prej anëtarëve përfaqësues të sektorit privat.

4. Të drejtat dhe detyrat e tjera të bordit, mandati, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe funksionimi i tij përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Bordi mbledhet një herë në 3 muaj dhe anëtarët e bordit përfitojnë shpërblim për çdo mbledhje nga të ardhurat e shkollës/qendrës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për shpërblimin e bordeve, nëse shkolla/qendra realizon të ardhura.”.

Neni 6

Nenet 8 dhe 9 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 8

**Licencimi i institucioneve private të arsimit dhe formimit profesional**

Licencimi i institucioneve private të arsimit profesional dhe/ose subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional bëhet në bazë të kushteve dhe kriterëve që përcaktohen në udhëzimet e nxjerra në mënyrë specifike për to nga ministritë përkatëse. Ky proces kryhet në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Licencimeve.

Neni 9

**Akreditimi i programeve të arsimit dhe formimit profesional**

1. Akreditimi i programeve të AFP-së kryhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), në përputhje me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në bazë të sistemit të sigurimit të cilësisë.

2. Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit për sistemin e arsimit profesional miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ndërsa për sistemin e formimit profesional miratohen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Neni 7

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “dhe në ato të mesme teknike publike dhe private” hiqen.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në qendrat e formimit profesional, publike dhe private, kurset dhe programet e formimit, riformimit dhe të rikualifikimit profesional të akredituara janë të hapura për të gjithë personat që

përmbushin kriteret për hyrjen, pranimin dhe regjistrimin në to, të përcaktuara si pjesë e procesit të akreditimit.”.

Neni 8

Neni 11 shfuqizohet.

Neni 9

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

**Hyrja, vijimi dhe transferimi nga një nivel/drejtimit i AFP-së në një nivel/drejtimit tjetër**

Hyrja, vijimi dhe transferimi nga një nivel/drejtimit i AFP-së në një nivel/drejtimit tjetër bëhet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Neni 10

Në fund të nenit 13 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Vlerësimi përfundimtar, bazuar në sistemin e krediteve në kualifikimet me orientim profesional, bëhet në përputhje me kriteret e paracaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.”.

Neni 11

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

**Certifikimi**

1. Certifikimi i nxënësve dhe kursantëve në AFP bëhet në përputhje me kriteret e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcakton llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumenteve të certifikimit për nxënësit në sistemin e arsimit profesional, sipas niveleve të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

3. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta përcakton llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumenteve të certifikimit për kursantët në sistemin e formimit profesional, sipas niveleve të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.”.

Neni 12

Në nenin 16, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Të gjitha ministratë e tjera, pushteti vendor, si dhe të gjithë përgjegjësit e tjerë të AFP-së, në nivel kombëtar apo vendor, janë të detyruar të japin informacion për veprimtaritë e AFP-së në këto dy ministri. Procedurat e mbledhjes, të raportimit të informacionit dhe shpeshësia e dhënies së informacionit përcaktohen me udhëzime të përbashkëta.”.

Neni 13

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Personeli i mësimdhënies teorike dhe praktike përbëhet nga:

- a) mësuesit e kulturës së përgjithshme;
  - b) mësuesit e kulturës profesionale;
  - c) mësuesit e formimit praktik në shkollat profesionale;
  - ç) instruktorët e formimit profesional në qendrat e formimit.
3. Trajnimi dhe kualifikimi fillestar i mësuesve dhe i instruktorëve, në përputhje me shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni, janë përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.”.
2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
- “4. Trajnimi dhe kualifikimi i vazhduar për personelin e angazhuar në institucionet arsimore profesionale janë përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, kurset për personelin e angazhuar në qendrat e formimit profesional janë përgjegjësi e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në përputhje me pikën 2 shkronja “ç” të këtij neni.”.

#### Neni 14

Nenet 18 dhe 19 ndryshohen si më poshtë:

#### “Neni 18 Shoqëritë tregtare

1. “Shoqëria tregtare” është subjekti ku mund të organizohen kurset e formimit nëpërmjet punës dhe ku mund të zhvillohen praktikat profesionale të nxënësve dhe të kursantëve të sistemit të AFP-së.
2. Shoqëritë tregtare, të cilat pranojnë nxënësit e shkollave profesionale për të zhvilluar praktikën mësimore, në kuadër të programit mësimor përkatës, mbështeten nga shteti. Format e mbështetjes, kriteret dhe kushtet për përfitimin e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Përfshirja e shoqërive në sistemin publik të AFP-së rregullohet me anë të marrëveshjeve që lidhen ndërmjet shoqërive tregtare dhe institucioneve ofruese arsimore publike. Kohëzgjatja e përfshirjes së shoqërive tregtare në sistemin publik kushtëzohet nga programet e praktikave profesionale dhe nga kurset e formimit.

#### Neni 19 Vlerësimi i sistemit

Mekanizmat e zhvillimit dhe të vlerësimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional janë përgjegjësi e ministrive përkatëse.”.

#### Neni 15

Në titullin e kreut III, fjalët “bashkërendimi i sistemit të” zëvendësohen me fjalën “koordinimi”.

#### Neni 16

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe në pikën 1, fjala “bashkërendim” zëvendësohet me fjalën “koordinim”.
2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
  - a) Në fillim të pikës 2 shtohen fjalët “Institucionet dhe”.
  - b) Në shkronjën “a” fjalët “dhe të mesëm teknik” hiqen.
  - c) Në shkronjën “c”, pjesa e fjalisë “të cilat duhet të bashkërendojnë punën me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për arsimimin profesional dhe të mesëm teknik, dhe me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për formimin profesional” hiqet.
  - ç) Pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d”, “dh”, “e” me këtë përmbajtje:
    - “d) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;
    - dh) Institucionet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
    - e) Institucione të tjera, të përcaktuara me akte nënligjore.”.

## Neni 17

Nenet 21, 22 dhe 23 ndryshohen si më poshtë:

### “Neni 21

#### **Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional**

1. Këshilli Kombëtar i AFP-së është organ këshillimor trepalësh (shtet-punëmarrës-punëdhënës). Ai u rekomandon ministrive përgjegjëse dhe Këshillit të Ministrave politika për zhvillimin e sistemit të AFP-së.

2. Këshilli Kombëtar i AFP-së përbëhet nga 10 anëtarë:

- a) Ministri i Arsimit dhe Shkencës, bashkëkryetar;
- b) Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bashkëkryetar;
- c) Një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- ç) Një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë;
- d) Katër anëtarë, përfaqësues të punëdhënësve;
- dh) Dy anëtarë përfaqësues të punëmarrësve.

3. Funkcionimi i Këshillit Kombëtar të AFP-së organizohet nga një sekretariat teknik, i cili përbëhet nga punonjës të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të AFP-së dhe e sekretariatit teknik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 22

#### **Kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në fushën e arsimit profesional**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka këto kompetenca:

- a) përpunon, zhvillon dhe zbaton politikat për reformimin dhe modernizimin e arsimit profesional, në përputhje me drejtimit europiane të zhvillimit të AFP-së;
- b) përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve që ofrojnë arsim profesional;
- c) përcakton kriteret e përgjithshme për marrjen në punë, për kualifikimin dhe për certifikimin e mësuesve në arsimin profesional, në bashkëpunim me institucionet e specializuara;
- ç) krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e arsimit profesional publik, që varen nga ajo, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- d) harton akte nënligjore për statusin e institucioneve publike ofruese të arsimit profesional, shkallën e autonomisë së tyre dhe funksionimin e bordit;
- dh) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Licencimeve, për licencimin e institucioneve arsimore private të arsimit profesional dhe vendos mbylljen e veprimtarisë së këtyre institucioneve, në rast shkeljeje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- e) miraton kurrikulat në nivel qendror për kualifikimet e arsimit profesional;
- ë) realizon testimin dhe certifikimin e nxënësve në shkollat e arsimit profesional, në bashkëpunim me institucionet e specializuara;
- f) mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të arsimit profesional që varen prej saj;
- g) nxjerr akte nënligjore të përbashkëta me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në mënyrë që, krahas arsimimit profesional të nxënësve, në shkollat profesionale, publike dhe private, të ofrohen edhe kurse formimi profesional, si shërbime për llogari të të tretëve.

## Neni 23

#### **Kompetencat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në fushën e AFP-së**

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka këto kompetenca:

- a) përpunon, zhvillon dhe zbaton politikat për reformimin dhe modernizimin e formimit profesional, në përputhje me drejtimit europiane të zhvillimit të AFP-së;



b) përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve të formimit profesional;

c) përcakton kriteret e përgjithshme për marrjen në punë, për kualifikimin dhe për certifikimin e instruktorëve të formimit profesional, në bashkëpunim me institucionet e specializuara;

ç) krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e formimit profesional në varësi të saj, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) harton akte nënligjore për statusin e institucioneve publike ofruese të formimit profesional, për shkallën e autonomisë së tyre dhe për funksionimin e bordit;

dh) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Licencimeve për licencimin e subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional;

e) miraton kurrikulat në nivel qendror për veprimtaritë e formimit profesional;

ë) merr pjesë në vlerësimin përfundimtar dhe në certifikimin e kursantëve në institucionet e formimit profesional që varen prej saj.

f) mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të formimit profesional që varen prej saj;

g) siguron vazhdimësinë e formimit profesional, në përputhje me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës;

gj) garanton të drejtën e individit për formimin profesional, duke lehtësuar pengesat ekonomike dhe shoqërore për vazhdimin e këtij formimi;

h) organizon kualifikimin e vazhdueshëm të instruktorëve të formimit profesional në sektorin publik, në bashkëpunim me institucionin e përcaktuar.”.

#### Neni 18

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a” hiqen fjalët “arsimit dhe”.

2. Shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” e “dh” ndryshohen si më poshtë:

“b) përgatishin kurrikulat e formimit profesional, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të përcaktuara me ligj;

c) organizojnë formimin, nëpërmjet punës, të punonjësve të tyre dhe rikualifikimin e specialistëve në institucionet që ofrojnë këtë shërbim;

ç) organizojnë testimin dhe certifikimin e specialistëve në institucionet që varen prej tyre;

d) marrin pjesë në procesin e hartimit të standardeve shtetërore të kualifikimeve profesionale, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;

dh) marrin pjesë në studime për analizën, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë që ofrohet në AFP, në bashkëpunim me institucionet e AFP-së.”.

#### Neni 19

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 24/1

#### **Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)**

1. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) është institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi kombëtar e unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar, bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve:

a) është një ndër njësitë zbatuese për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe shërben si sekretariat për Këshillin e KSHK-së;

b) harton plane dhe programe për zhvillimin e sistemit të AFP-së, që miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

c) harton programe për realizimin e politikave për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

ç) harton programe për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AFP-së.

3. AKAFPK-ja është një ofrues shërbimi për ministrinë përkatëse.
4. AKAFPK-ja mban regjistrin kombëtar të kualifikimeve kombëtare.
5. Organizimi dhe veprimtaria e AKAFPK-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 20

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:  
“a) propozon hapjen dhe mbylljen e drejtimeve, profileve, specialiteteve në shkollat profesionale, si dhe hapjen e shkollave të reja, në përputhje me nevojat e zhvillimit rajonal.”.
2. Në fillim të shkronjës “b” shtohen fjalët “në bashkëpunim me institucionet ofruese të AFP-së”.
3. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:  
“ç) përfaqësues të pushtetit vendor marrin pjesë në bordet e shkollave.”.

#### Neni 21

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:  
“a) propozojnë hapjen dhe mbylljen e drejtimeve, profileve, specialiteteve në shkollat profesionale dhe në qendrat e formimit profesional, si dhe hapjen e shkollave ose qendrave të reja, në përputhje me nevojat e punësimit dhe zhvillimit ekonomik të vendit.”.
2. Në shkronjën “b”, pas fjalëve “të standardeve kombëtare” shtohen fjalët “të arsimit dhe”.
3. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:  
“c) organizojnë kurse formimi profesional, sipas nevojave specifike të fushave që ata mbulojnë.”.
4. Pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:  
“dh) marrin pjesë në zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave për reformat në AFP;  
e) përfaqësues të tyre marrin pjesë në bordet e shkollave.”.

#### Neni 22

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Lista kombëtare e profesioneve dhe lista kombëtare e kualifikimeve profesionale miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të rekomandimeve të AKAFPK-së dhe në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe partnerët socialë.”.

#### Neni 23

Neni 28 shfuqizohet.

#### Neni 24

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

#### **Vetëfinancimi**

1. Institucionet ofruese publike të arsimit dhe formimit profesional mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve dhe të praktikave mësimore. Format dhe mënyrat e organizimit të veprimtarive ekonomike të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional veprojnë si njësi ekonomike, me llogari më vete. Për realizimin e veprimtarive prodhuese dhe të shërbimeve, ato kontraktjnë persona fizikë dhe juridikë, me kusht që këto veprimtari të jenë në përputhje me qëllimin e institucionit për realizimin e programeve të arsimit dhe formimit profesional dhe të mos përbëjnë qëllim në vetvete.”.

Neni 25

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që të nxjerrin aktet nënligjore në fushën e arsimit dhe formimit profesional brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7040, datë 6.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

## **LIGJ**

**Nr.10 435, datë 23.6.2011**

### **PËR SHËRBIMIN E KËRKIM-SHPËTIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i autoriteteve, rregullave dhe procedurave për organizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit, me qëllim shpëtimin e jetës njerëzore, duke përdorur me efektivitet të gjitha burimet e mundshme në kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit, në raste fatkeqësish të ndryshme, duke ndërhyrë, kërkuar, gjetur dhe shpëtuar persona të humbur ose të zhdukur.

**Neni 2**

#### **Fusha e zbatimit të ligjit**

Ky ligj zbatohet në hapësirën tokësore, detare e në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe në zonat e përgjegjësive, të ndara sipas marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, të nënshkuara nga Republika e Shqipërisë.

### Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Faza e alarmit” është situata kur mendohet se mjeti ajror/anija ose njësia tokësore janë të pasigurta.
2. “Faza e emergjencës” është situata që tregon, sipas rastit, fazë pasigurie, alarmi ose rreziku.
3. “Faza e paqartësisë” është një situatë kur ekziston paqartësia në lidhje me sigurinë e mjetit dhe personave në bord.
4. “Faza e rrezikut” është situata në të cilën është e sigurt se personi/personat apo mjeti ajror/anija ndodhen në rrezik serioz, ose kanë nevojë për një ndihmë të menjëhershme.
5. “ICAO” është Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.
6. “IMO” është Organizata Ndërkombëtare Detare.
7. “SAR” është Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
8. “Mjet detar SAR” është mjeti detar i destinuar për operacione SAR, me pajisje dhe personel të nevojshëm për operacionet detare SAR.
9. “Mjet ajror SAR” është mjeti ajror i konfiguruar për misione kërkim-shpëtimi.
10. “Njësi shpëtimi” janë njësitë e përbëra nga personel i stërvitur e i kompletuar me mjetet dhe pajisjet e përshtatshme për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
11. “Operacion ndërhyrjeje” janë veprimet për shpëtimin e jetës së njerëzve, në një territor të prekur nga fatkeqësia.
12. “Rajoni i kërkim-shpëtimit” është një zonë e përcaktuar brenda së cilës sigurohen shërbimet e kërkim-shpëtimit.
13. “RCC” është Qendra e Koordinimit të Shpëtimit.
14. “Subjekte private” janë individët dhe subjektet e përcaktuara në nenin 26 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

## KREU II ORGANIZIMI, STRUKTURA, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT KRYESORE TË SHËRBIMIT TË KËRKIM-SHPËTIMIT

### Neni 4 Organizimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit

1. Shërbimi i kërkim-shpëtimit organizohet në nivel kombëtar.
2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura caktohet Koordinatori Kombëtar i Kërkimit dhe Shpëtimit (KKKSH) në Republikën e Shqipërisë. KKKSH-ja drejton operacionet e kërkim-shpëtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.
3. Forcat Ajrore të Republikës së Shqipërisë caktohen Koordinator Kombëtar Ajror i Kërkimit e Shpëtimit (KKAKSH). KKAKSH-ja drejton operacionet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Ajrore të Kërkim-Shpëtimit.
4. Roja Bregdetare caktohet Koordinator Kombëtar Detar i Kërkimit e Shpëtimit (KKDKSH). KKDKSH-ja drejton operacionet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Detare të Kërkim-Shpëtimit.

### Neni 5 Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit

1. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Mbrojtjes, dhe ka si qëllim planizimin, organizimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
2. Organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e tjera shtetërore, si dhe mënyra dhe procedurat e operimit të sistemit, duke përfshirë edhe linjën e komandimit e kontrollit me koordinatorët kombëtarë të ajrit e detit për ofrimin e shërbimit të kërkimit e shpëtimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

#### Neni 6 Përgjegjësitë

1. Organet shtetërore, të përcaktuara në këtë ligj, janë përgjegjëse për të dhënë ndihmë në operacionet e kërkim-shpëtimit.

2. Institucionet e tjera shtetërore si dhe subjektet private, sa herë u kërkohet nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, janë të detyruara të ofrojnë ndihmën e tyre në njerëz dhe mjete.

3. Përdorimi i mjeteve të subjekteve private, për qëllime të kërkim-shpëtimit, kompensohet në masën dhe sipas procedurës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Çdo mjet ajror/detar, si dhe çdo shtetas shqiptar, në përputhje me mundësitë reale, ka për detyrë të lajmërojë për çdo aksident të vrotuar dhe të kontribuojë në dhënien e ndihmës.

#### Neni 7 Detyrat e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit

1. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, në zbatim të këtij ligji, kryen edhe rolin e Qendrës së Koordinimit të Shpëtimit (RCC), si dhe ka këto detyra kryesore:

a) siguron koordinimin e përgjithshëm të operacioneve të shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe mban kontakte të drejtpërdrejta me shërbimet homologe të shteteve të tjera;

b) lokalizon mjetet ajrore e detare dhe personat në bordin e tyre, që janë në rrezik dhe/ose të aksidentuar në rajonin e kërkim-shpëtimit të Republikës së Shqipërisë dhe drejton për në vendin e aksidentuar, sa më shpejt të jetë e mundur, njësitë e nevojshme të shpëtimit;

c) drejton operacionet e shpëtimit të jetës njerëzore, duke përcaktuar përparësitë e ndërhyrjeve;

ç) siguron ndihmë për mjetet ajrore e detare dhe për personat në rrezik në bordin e tyre në zonën e përgjegjësisë, në përputhje me mundësitë reale;

d) në rast hetimesh, bashkëpunon dhe shkëmben të dhënat e mbledhura me autoritetet kompetente kombëtare e ndërkombëtare;

dh) planifikon dhe specifikon detyrimet e nevojat për përdorim sa më racional të burimeve e të mjeteve;

e) bashkëpunon në fushën e shërbimit të kërkim-shpëtimit, sipas ICAO-së, IMO-së, me shërbimet homologe të vendeve fqinje, me të cilat janë nënshkruar marrëveshje në fushën e kërkim-shpëtimit;

ë) kur e gjykon të arsyeshme, njofton menjëherë strukturat e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, ministrinë përgjegjëse për transportin dhe punët publike, ministrinë përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave dhe strukturat e tjera publike, për t'u ardhur në ndihmë në rast aksidentesh.

2. Kompetencat e detajuara të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit dhe Koordinatorit Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### KREU III DETYRAT E INSTITUCIONEVE QENDRORE PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË KËRKIM-SHPËTIMIT

#### Neni 8 Këshilli i Ministrave

1. Këshilli i Ministrave miraton "Planin kombëtar për shërbimin e kërkim-shpëtimit", të bashkëpropozuar nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, ministria përgjegjëse për punët publike dhe transportin dhe ministria përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave.

2. Programet për pajisjen dhe modernizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 9  
**Ministri i Mbrojtjes**

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të shërbimit të kërkim-shpëtimit e zbatimin e politikave në këtë fushë, si dhe kryen këto detyra:

- a) nënshkruan marrëveshje në përputhje me konventat ndërkombëtare, në fushën e kërkim-shpëtimit, në të cilat aderon Republika e Shqipërisë;
- b) nënshkruan marrëveshje me vendet fqinje, për kushtet e hyrjes së njësive të kërkim-shpëtimit në hapësirën ajrore, detare, ujërat territoriale dhe territorin e vendeve respektive;
- c) miraton tabelën e organizimit dhe pajisjeve të strukturave operacionale të shërbimit të kërkim-shpëtimit;
- ç) miraton rregullore, udhëzime dhe manuale për funksionimin e strukturave operacionale të shërbimit të kërkim-shpëtimit;
- d) ndjek zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet shtetërore dhe subjektet private në fushën e shërbimit të kërkim-shpëtimit.

Neni 10  
**Ministria e Brendshme**

Ministria e Brendshme, në zbatim të këtij ligji, kryen këto detyra:

- a) mbështet, me kapacitetet e saj, operacionet e kërkim-shpëtimit;
- b) informon menjëherë strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit, në rastet e aksidenteve ajrore, detare, katastrofave dhe fatkeqësive të ndryshme;
- c) siguron ruajtjen e rajonit të aksidentit, sipas kërkesës së Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit;
- ç) siguron qarkullimin rrugor, pa pengesa, të strukturave operacionale të kërkim-shpëtimit për në rajonin e kërkimit;
- d) identifikon personat që japin informacion të rremë;
- dh) kontribuon, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj, për identifikimin e viktimave;
- e) bashkërendon veprimet me strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

Neni 11  
**Ministria përgjegjëse për punët publike dhe transportin**

Ministria përgjegjëse për punët publike dhe transportin, përveç detyrimeve që rrjedhin nga akte të tjera ligjore a nënligjore, në zbatim të këtij ligji, kryen edhe këto detyra:

- a) mbështet, me kapacitetet e saj, operacionet e kërkim-shpëtimit;
- b) informon menjëherë strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit, për pozicionin, kursin, shpejtësinë dhe sinjalet e thirrjes së avionëve/anijeve në rrezik, brenda rajonit kombëtar të kërkim-shpëtimit;
- c) transmeton dhe ndërhyr menjëherë tek avionët/anijet, që ndodhen në afërsi të incidentit, për dhënie ndihme, duke marrë përgjegjësitë e përcaktuara në konventat ndërkombëtare të pranuar me ligj;
- ç) kufizon ose ndalon, përkohësisht, fluturimin dhe lundrimin në të gjithë territorin e vendit ose në një pjesë të tij, kur i kërkohet nga strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit, gjatë periudhës së emergjencës.

Neni 12  
**Ministria përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave**

Ministria përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave, në zbatim të këtij ligji, kryen këto detyra:

- a) mbështet, me kapacitetet e saj, operacionet e kërkim-shpëtimit;
- b) informon menjëherë strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit për pozicionin, kursin, shpejtësinë dhe për sinjalet e thirrjes së anijeve në rrezik, brenda rajonit kombëtar të kërkim-shpëtimit;

c) transmeton dhe ndërhyjnë menjëherë tek anijet që ndodhen në afërsi të incidentit, për dhënie ndihme, duke marrë përgjegjësitë e përcaktuara në konventat ndërkombëtare të pranuar me ligj;

ç) nëpërmjet rrjetit të agjencive rajonale të mjedisit dhe Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve, identifikon shkallën e ndotjes dhe rezultatet i bën publike, kur incidenti shoqërohet me ndotje të mjedisit (ajrit, ujërave, tokës);

d) merr përgjegjësitë ligjore, që vijnë si rrjedhim i aderimit në konventat ndërkombëtare, kur shkalla e ndotjes është e lartë dhe rrezikon ndotjen e ujërave ndërkufitare.

#### KREU IV

### PROCEDURAT E LEJIMIT TË HYRJES SË MJETEVE DHE PERSONELIT TË HUAJ TË KËRKIM-SHPËTIMIT DHE TË PJESEMARRJES SË NJËSIVE SHQIPTARE “SAR” NË OPERACIONE KËRKIM-SHPËTIMI JASHTË VENDIT

#### Neni 13

1. Leja për hyrjen në vendin tonë të mjeteve ajrore, lundruese dhe mjeteve e njësive tokësore të huaja të shërbimit të kërkim-shpëtimit, me mision kërkim-shpëtimit, pas kërkesës për ndërhyrje nga autoritetet kompetente të vendeve të huaja, me të cilat kemi marrëveshje, jepet nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit.

2. Leja për daljen jashtë vendit të mjeteve ajrore, lundruese, si dhe mjeteve e njësive tokësore të shërbimit të kërkim-shpëtimit shqiptar, me mision kërkim-shpëtimit, pas kërkesës për ndërhyrje nga autoritetet kompetente të vendeve të huaja, me të cilat kemi marrëveshje, jepet nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit.

3. Në të dyja rastet operacionet e kërkim-shpëtimit drejtohen nga strukturat operationale të kërkim-shpëtimit të vendeve ku kryhen misionet e kërkim-shpëtimit.

#### KREU V

### KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

#### Neni 14

#### **Kundërvajtjet administrative**

1. Mosrespektimi i detyrimeve, që përcakton pika 2 e nenit 6 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 150 000 lekë.

2. Gjoha vendoset nga Kryetari i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

#### Neni 15

#### **E drejta për ankim**

1. Subjektet, të cilat gjobiten sipas nenit 14 të këtij ligji, kanë të drejtën e ankimit, në rrugë administrative, te Ministri i Mbrojtjes, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Pas shterimit të rrugës administrative, subjektet e gjobitura kanë të drejtë të ankohen, në rrugë gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të gjobës.

#### KREU VI

### DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 16

#### **Financimi**

1. Ministria e Mbrojtjes, në buxhetin e saj, parashikon përballimin e shpenzimeve për Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

2. Ministria e Brendshme dhe ministria përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave parashikojnë në buxhetet e tyre përballimin e shpenzimeve për shërbimin e kërkim-shpëtimit, sipas kompetencave respektive.

3. Shpenzimet e tjera, për angazhimin e strukturave në varësi të ministrisë përgjegjëse për punët publike dhe transportin, përballohen në përputhje me dispozitat e nenit 90 të ligjit nr.10 040, datë 22.10.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 17

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 2, 6 pika 3, 7 pika 2 dhe 8 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Kryeministri të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji.
3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 18

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7041, datë 6.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**

**Nr.10 436, datë 28.6.2011**

### **PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN “PËR REDUKTIMIN E MËTEJSHËM TË ÇLIRIMIT TË SQUFURIT” TË KONVENTËS “PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË RREZE TË GJATË”, 1979**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin “Për reduktimin e mëtejshëm të çlirimit të squfurit” të konventës “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në rreze të gjatë”, 1979, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7042, datë 6.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



**PROTOKOLL I KONVENTËS 1979**  
**MBI NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË RREZE TË GJATË PËR REDUKTIMIN E**  
**MËTEJSHËM TË ÇLIRIMIT TË SQUFURIT**

Palët,

*të vendosura* për të zbatuar Konventën për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Rreze të Gjatë;

*të shqetësuara* që çlirimi i sqfurit dhe ndotësve të tjerë të ajrit vazhdon të transportohet përtej kufijve ndërkombëtarë dhe të shkaktojë në pjesë të ekspozuara të Europës dhe Amerikës së Veriut dëmtim të shumëpërhapur të burimeve natyrore me rëndësi të madhe ekonomike dhe mjedisore, siç janë: pyjet, tokat dhe ujërat; dhe të materialeve, duke përfshirë monumentet historike dhe, sipas disa rrethanave, të ketë pasoja të dëmshme mbi shëndetin e njeriut;

*të vendosura* të marrin masa parandaluese për të paraprirë, parandaluar ose minimizuar çlirimin e ndotësve të ajrit dhe për të zbutur pasojat e tyre të dëmshme;

*të bindura* që në rast të rrezikut për dëm të madh apo të pakthyeshëm, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk duhet të përdoret si arsye për të shtyrë në kohë këto masa, duke pasur parasysh që këto masa parandaluese për çlirimin e ndotësve të ajrit duhet të jenë me kosto efektive;

*të vetëdijshme* që masat për të kontrolluar çlirimin e sqfurit dhe ndotësve të tjerë të ajrit do të kontribuonin në mbrojtjen e mjedisit sensitiv të arktikut;

*duke konsideruar* që burimet mbizotëruese të ndotjes së ajrit, që kontribuojnë në acidifikimin e mjedisit janë djegia e lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë dhe proceset kryesore teknologjike në sektorë të ndryshëm industrialë, si dhe transportimi, që çon në çlirimin e sqfurit, oksidit të nitrogjenit dhe ndotësve të tjerë;

*të ndërgjegjshëm* për nevojën për përjasje rajonale me kosto efektive për të luftuar ndotjen e ajrit që merr parasysh variacionet në pasoja dhe kostot e pakësimit ndërmjet vendeve;

*me dëshirën* për të marrë veprim të mëtejshëm dhe më të efektshëm për të kontrolluar dhe reduktuar çlirimin e sqfurit;

*në dijeni që* çdo politikë për kontrollin e sqfurit, sado me kosto të efektshme, që mund të jetë në nivel rajonal, do të rezultojnë në barrë relativisht të madhe ekonomike mbi vendet që kanë ekonomi në tranzicion për një ekonomi tregu;

*duke pasur parasysh* që masat e marra për të reduktuar çlirimin e sqfurit nuk duhet të përbëjnë një mjet për diskriminim arbitrar ose të pajustificueshëm, ose një kufizim të fshehur mbi konkurrencën dhe tregtinë ndërkombëtare;

*duke pasur parasysh* të dhënat ekzistuese shkencore dhe teknike për çlirimin, proceset atmosferike dhe pasojat mbi mjedisin e oksid sqfurit, si dhe për kostot e pakësimit;

*në dijeni që*, përveç çlirimit të sqfurit, çlirimi i oksidit të nitrogjenit dhe i amoniakut shkaktojnë, gjithashtu, acidifikim të mjedisit;

*duke theksuar* që sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës, miratuar në Nju-Jork më 9 maj 1992, është rënë dakord për krijimin e politikave kombëtare dhe për të marrë masat përkatëse për të luftuar ndryshimin e klimës, që mund të pritet të çojnë në reduktim të çlirimit të sqfurit;

*duke përsëritur* nevojën për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor;

*duke pranuar* nevojën për të vazhduar bashkëpunimin shkencor dhe teknik për të shtjelluar më tej përjasjen bazuar në ngarkesat kritike dhe nivelet kritike, duke përfshirë përpjekjet për të vlerësuar ndotës të ndryshëm të ajrit dhe efekte të ndryshme për mjedisin, materialet dhe shëndetin e njeriut;

*duke theksuar* që njohuritë shkencore dhe teknike po zhvillohen dhe do të jenë të nevojshme për të marrë parasysh këto zhvillime në rishikimin e përshtatshmërisë së detyrimeve të marra përsipër sipas këtij protokollit dhe në vendimmarrjen për veprim të mëtejshëm;

*duke pranuar* protokollin për reduktimin e çlirimit të sqfurit ose flukseve ndërkufitare me të paktën 30%, miratuar në Helsinki më 8 korrik 1985 dhe masat e marra tashmë nga shumë vende që kanë pasur efektin e reduktimit të çlirimit të sqfurit.

*kanë rënë dakord* si më poshtë:

## Neni 1 Përkufizime

Për qëllime të këtij protokollit:

1. “Konventë” do të thotë Konventa mbi Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Rreze të Gjatë, miratuar në Gjenevë më 13 nëntor 1979.
2. “EMEP” do të thotë programi bashkëpunues për monitorimin dhe vlerësimin e transmetimit me rreze të gjatë të ndotësve të ajrit në Europë.
3. “Organ ekzekutiv” do të thotë organi ekzekutiv për Konventën i krijuar sipas nenit 10, paragrafi 1 të Konventës.
4. “Komision” do të thotë Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën.
5. “Palë”, do të thotë palët e këtij protokollit, përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti.
6. “Shtirja gjeografike e EMEP” do të thotë zona e përcaktuar në nenin 1, paragrafi 1 të protokollit të Konventës së 1979-ës mbi Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Rreze të Gjatë për financimin afatgjatë të programit bashkëpunues për monitorimin dhe vlerësimin e transmetimit në rreze të gjatë të ndotësve të ajrit në Europë (EMEP) dhe miratuar në Gjenevë më 28 shtator 1984.
7. “SOMA” do të thotë zona e menaxhimit të oksid sqfurit, e përcaktuar në aneksin III, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 3.
8. “Ngarkesë kritike” do të thotë një vlerësim sasior i një ekspozimi ndaj një ose më shumë ndotësve nën të cilin mund të ndodhin efekte të mëdha të dëmshme mbi elemente të specifikuar sensitive të mjedisit, sipas informacionit që kemi.
9. “Nivele kritike” do të thotë përqendrim i ndotësve në atmosferë mbi të cilin mund të ndodhin efekte të drejtpërdrejta të dëmshme për receptorët/marrësit, siç janë: qeniet njerëzore, bimët, ekosistemet ose materialet, sipas informacionit që kemi.
10. “Depozitim kritik i sqfurit” do të thotë një vlerësim sasior i ekspozimit ndaj përzierësve të sqfurit të oksiduar, duke pasur parasysh efektet e përhithjes së kationit bazë dhe depozitimit të kationit bazë, nën të cilin nuk ndodhin efekte të mëdha të dëmshme për elemente të specifikuar sensitive të mjedisit, sipas informacionit që kemi.
11. “Çlirim” do të thotë çlirim i substancave në atmosferë.
12. “Çlirim i sqfurit” do të thotë gjithë çlirim i përzierësve të sqfurit, i shprehur në kilotonë dyoksid sqfuri (kt SO<sub>2</sub>) në atmosferë që e kanë origjinën nga burime antropogjenike, duke përjashtuar anijet në qarkullimin ndërkombëtar jashtë ujërave territoriale.
13. “Lëndë djegëse” do të thotë çdo material i djegshëm i ngurtë, i lëngshëm ose i gaztë me përjashtim të mbeturinave në vend dhe mbetjeve toksike ose të rrezikshme.
14. “Burim i palëvizshëm i djegies” do të thotë çdo pajisje teknike apo grup i pajisjeve teknike që ndodhet në një vend të përbashkët dhe është ose mund të çlirojë gazra nëpërmjet një gypi të përbashkët ku lëndët djegëse oksidohen me qëllime që të përdoret nxehtësia e çliuar.
15. “Burimi kryesor i ri i palëvizshëm i djegies” do të thotë çdo burim i palëvizshëm i djegies, ndërtimi apo modifikimi thelbësor i të cilit autorizohet pas 31 dhjetorit 1995 dhe inputi termik i të cilit, kur funksionon në kapacitet të vlerësuar është të paktën 50 MWth. I takon autoriteteve kompetente kombëtare të vendosin nëse një modifikim është thelbësor apo jo, duke pasur parasysh faktorë si përfitime mjedisore të modifikimit.
16. “Burimi kryesor ekzistues i palëvizshëm i djegies” do të thotë çdo burim ekzistues i palëvizshëm i djegies, inputi termik i të cilit, kur funksionon me kapacitetin e vlerësuar është të paktën 50 MWth.
17. “Gazoil” do të thotë çdo produkt naftë brenda HS 2710, ose çdo produkt tjetër naftë që, për shkak të kufijve të tij të distilimit, përfshihet në kategorinë e distiluesve të mesëm të synuar për t'u përdorur si lëndë djegëse dhe të paktën 85 për qind në vëllimin e të cilit, përfshirë humbjet e distilimit, distilohet në 350°C.
18. “Vlera kufi e çlirimit” do të thotë përqendrim i lejuar i përzierësve të sqfurit të shprehur si dyoksid sqfuri në gazra të mbetura nga një burim i lëvizshëm i djegies, të shprehur në lidhje me masën për vëllim të gazrave të mbetura të shprehura në mg SO<sub>2</sub>/Nm<sup>3</sup>, duke prezumuar një përmbajtje oksigjeni në vëllim të gazit të mbetur prej 3 për qind në rastin e lëndëve djegëse të lëngshme dhe të gazta, dhe 6 për qind në rastin e lëndëve djegëse të ngurta.

19. "Kufizim i çlirimit" do të thotë sasia e plotë e lejueshme e përzierësve të sqfurit e shprehur si dyoksid sqfuri i çliruar nga një burim djegieje ose grup i burimeve të djegies, që ndodhen ose në një vend të përbashkët ose brenda një zone të caktuar gjeografike, i shprehur në kilotonë në vit.

20. "Norma e desqfurizimit" do të thotë raporti i sasisë së sqfurit që ndahet në vendin e burimit të djegies gjatë një periudhe të caktuar me sasinë e sqfurit që ka lënda djegëse që futet në ambiente të burimit të djegies dhe që përdoret për të njëjtën periudhë.

21. "Buxhet i sqfurit" do të thotë një matriks i kontributeve të llogaritura për depozitimim e përbërësve të sqfurit të oksiduar në zonat marrëse, që rrjedh nga çlirimet nga zonat specifike.

## Neni 2

### Detyrime bazë

1. Palët kontrollojnë dhe reduktojnë çlirimin nga ato të sqfurit për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga efektet e dëmshme, sidomos efektet acidifikuese dhe për të siguruar, sa të jetë e mundur, pa kosto të tepërta, që depozitime të përbërësve të sqfurit të oksiduar në periudhën afatgjatë të mos kalojnë ngarkesën kritike për sqfurin e dhënë, në aneksin I, si depozitim kritik i sqfurit, në përputhje me njohuritë shkencore aktuale.

2. Si hap i parë, palët, minimalisht, reduktojnë dhe mbajnë çlirimin vjetor të sqfurit nga ato në përputhje me kohën dhe nivelet e specifikuar në aneksin II.

3. Gjithashtu, çdo palë:

a) sipërfaqja totale e së cilës është më e madhe se 2 milionë kilometër katror;

b) që është e angazhuar sipas paragrafit 2 më sipër për një tavan kombëtar të çlirimit të sqfurit jo më shumë sesa niveli më i ulët i çlirimit të tij në 1990-ës apo për detyrimin e saj në protokollin e Helsinkit 1985 për reduktimin e çlirimit të sqfurit ose flukseve ndërkufitare me të paktën 30%, siç tregohet në aneksin II.

c) çlirimet vjetore të sqfurit të të cilës kontribuojnë në acidifikimin në zona nën juridiksionin e një ose më shumë palëve e kanë origjinën vetëm nga brenda zonave nën juridiksionin e saj që janë renditur si SOMA në aneksin II dhe ka paraqitur dokumentacion për këtë qëllim; dhe

d) që ka specifikuar me nënshkrimin apo aderimin në këtë protokoll, qëllimin e saj për të vepruar në përputhje me këtë paragraf, minimalisht redukton dhe mban çlirimin vjetor të sqfurit në zonën e renditur në përputhje me kohën dhe nivelet e specifikuar në aneksin II.

4. Gjithashtu, palët përdorin masat më të efektshme për reduktimin e çlirimit të sqfurit, të përshtatshme në rrethanat e tyre të veçanta për burimet e reja dhe ekzistuese, që përfshijnë, ndër të tjera:

Masa për të rritur efikasitetin e energjisë;

Masa për të rritur përdorimin e energjisë së ripërtërishme;

Masa për të reduktuar përmbajtjen e sqfurit të lëndëve djegëse të veçanta dhe për të inkurajuar përdorimin e lëndëve djegëse me përmbajtje të ulët të sqfurit, duke përfshirë përdorimin e kombinimit të lëndëve djegëse me përmbajtje të lartë sqfuri dhe ato me përmbajtje të ulët sqfuri, ose të lëndëve djegëse pa përmbajtje sqfuri;

Masa për të zbatuar më mirë teknologji kontrolli që nuk kërkojnë kosto të tepërta, duke përdorur udhëzimin në aneksin IV.

5. Çdo palë, përveç atyre palëve që i nënshtrohen Marrëveshjes së Shteteve të Bashkuara/Kanadasë për Cilësinë e Ajrit të 1991-it, minimalisht:

a) aplikon vlerat kufi të çlirimit të paktën po kaq shtrënguese sa ato që janë specifikuar në aneksin V për të gjitha burimet e mëdha të reja të palëvizshme të djegies;

b) jo më vonë se 1 korriku 2004 zbaton sa më shumë të jetë e mundur pa kosto të tepërta vlerat kufi të çlirimit, të paktën po aq shtrënguese sa ato të specifikuar në aneksin V për ato burime kryesore ekzistuese të palëvizshme të djegies, inputi termik i të cilave është mbi 500 MWth, duke pasur parasysh kohën e mbetur të ekzistencës së një impianti, të llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollin ose zbaton kufizime të ngjashme të çlirimit, apo dispozita të tjera të përshtatshme, me kusht që këto të arrijnë tavanet e çlirimit të sqfurit, të specifikuar në aneksin II dhe rrjedhimisht, të afrohet më tej me ngarkesat kritike, siç jepen në aneksin I; dhe jo më vonë se 1 korriku 2004, zbaton vlerat kufi të çlirimit, ose kufizime të çlirimit për ato burime kryesore ekzistuese të palëvizshme të djegies, inputi termik i të cilave është ndërmjet 50 dhe 500 MWth, duke përdorur aneksin V si udhëzues;

c) jo më vonë se dy vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokoll, zbaton standarde kombëtare për përmbajtjen e squfurit të gazoil të paktën po aq shtrënguese sa ato të specifikuara në aneksin V. Në rastet kur nuk mund të sigurohet furnizimi me gazoil, një shtet mund të shtrijë afatin kohor të dhënë në këtë nënparagraf për një periudhë deri në dhjetë vjet. Në këtë rast ai specifikon në një deklaratë që depozitohet së bashku me instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, synimin e tij për të shtyrë periudhën kohore.

6. Palët, gjithashtu, mund të zbatojnë instrumente ekonomike për të inkurajuar metoda me kosto të efektshme për reduktimin e çlirimit të squfurit.

7. Palët e këtij protokoll, në një seancë të organit ekzekutiv, në përputhje me rregullat dhe kushtet që organi ekzekutiv i shtjellon dhe i miraton, vendosin nëse dy ose më shumë palë mund të zbatojnë së bashku detyrimet e përcaktuara në aneksin II. Këto rregulla dhe kushte sigurojnë plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 2 më sipër dhe, gjithashtu, nxitin arritjen e qëllimeve mjedisore të përcaktuara në paragrafin 1 më sipër.

8. Palët, sipas rezultatit të rishikimit të parë të parashikuar në nenin 8 dhe jo më vonë se një vit pas përfundimit të këtij rishikimi, fillojnë negociatat për detyrimet e mëtejshme për të reduktuar çlirimit.

### Neni 3

#### **Shkëmbimi i teknologjisë**

1. Palët, në përputhje me legjislacionet e tyre të brendshme, rregulloret dhe praktikat, lehtësojnë shkëmbimin e teknologjive dhe teknikave, duke përfshirë ato që rritin efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë së ripërtërishme dhe përpunimin e lëndëve djegëse me nivele të ulëta squfuri, për të reduktuar çlirimin e squfurit, sidomos nëpërmjet promovimit:

- a) të shkëmbimit tregtar të teknologjisë në dispozicion;
- b) të kontakteve të drejtpërdrejta industriale dhe bashkëpunim, duke përfshirë sipërmarrje të përbashkëta;
- c) të shkëmbimit të informacionit dhe përvojës;
- d) të sigurimit të asistencës teknike.

2. Në nxitjen e veprimtarive të specifikuara në paragrafin 1 më sipër, palët krijojnë kushte të favorshme duke lehtësuar kontakte dhe bashkëpunim mes organizatave të përshtatshme dhe individëve në sektorët publikë dhe privatë që janë në gjendje të sigurojnë teknologji, shërbime projektimi dhe inxhinierike, pajisje apo financim.

3. Palët, jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokoll aktual, fillojnë të konsiderojnë procedurat për të krijuar kushte më të favorshme për shkëmbimin e teknologjisë për të reduktuar çlirimin e squfurit.

### Neni 4

#### **Strategji kombëtare, politika, programe, masa dhe informacion**

1. Çdo palë, për të zbatuar detyrimet sipas nenit 2:

a) miraton strategji kombëtare, politika dhe programe, jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll; dhe

b) merr dhe zbaton masa kombëtare për të kontrolluar dhe reduktuar çlirimin e squfurit.

2. Çdo palë mbledh dhe mban informacion për:

a) nivelet aktuale të çlirimit të squfurit dhe të përqendrimeve mjedisore dhe depozitimeve të squfurit të oksiduar dhe përzierësve të tjerë acidifikues, duke pasur parasysh planin e punës së EMEP-it për ato palë që janë brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-it; dhe

b) pasojat e depozitimeve të squfurit të oksiduar dhe përzierës të tjerë acidifikues.

### Neni 5

#### **Raportimi**

1. Çdo palë i raporton rregullisht, siç përcaktohet nga organi ekzekutiv, nëpërmjet Sekretarit Ekzekutiv të Komisionit, organit ekzekutiv, informacion për:

a) zbatimin e strategjive kombëtare, politikave, programeve dhe masave të përmendura në nenin 4, paragrafi 1;

b) nivelet e çlirimit kombëtar vjetor të sqfurit, në përputhje me udhëzimet e miratuara nga organi ekzekutiv, që përmban të dhëna për çlirimin për të gjitha kategoritë e rëndësishme të burimeve; dhe

c) zbatimin e detyrimeve të tjera që ka marrë përsipër sipas këtij protokolli.

Në përputhje me një vendim në lidhje me formën dhe përmbajtjen për t'u miratuar nga palët në një seancë të organit ekzekutiv. Kushtet e këtij vendimi do të rishikohen sipas nevojës për të identifikuar elementet shtesë në lidhje me formën dhe/ose përmbajtjen e informacionit që duhet të përfshihet në raporte.

2. Çdo palë brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-it i raporton EMEP-it, nëpërmjet Sekretarit Ekzekutiv të Komisionit, rregullisht, siç përcaktohet nga organi drejtues i EMEP-it dhe siç miratohet nga palët në një seancë të organit ekzekutiv, informacion për nivelet e çlirimit të sqfurit me përcaktime kohore dhe hapësinore siç specifikohet nga organi drejtues i EMEP-it.

3. Në kohë, përpara çdo seance vjetore të organit ekzekutiv, EMEP-i jep informacion për:

a) përqendrimet mjedisore dhe depozitimet e përzierësve të sqfurit të oksiduar; dhe

b) llogaritjet e buxhetit të sqfurit.

Palët në zona jashtë shtrirjes gjeografike të EMEP-it vënë në dispozicion informacion të ngjashëm nëse kërkohet nga organi ekzekutiv.

4. Organi ekzekutiv në përputhje me nenin 10, paragrafi 2(b) të Konventës merret me përgatitjen e informacionit për pasojat e depozitimit të sqfurit të oksiduar dhe përzierësve të tjerë acidifikues.

5. Palët, në seancat e organit ekzekutiv, merren me përgatitjen në intervale të rregullta të informacionit të rishikuar për alokime të llogaritura dhe të përmirësuar në nivel ndërkombëtar për reduktimin e çlirimit të sqfurit në shtetet brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-it, me modele vlerësimi të integruara, me qëllim për të reduktuar më tej, për qëllime të nenit 2, paragrafit 1 të këtij protokolli, ndryshimin ndërmjet depozitimeve aktuale të përzierësve të sqfurit të oksiduar dhe vlerave të ngarkesës kritike.

## Neni 6

### **Kërkimi, zhvillimi dhe monitorimi**

Palët inkurajojnë kërkim, zhvillim, monitorim dhe bashkëpunim në lidhje me:

a) harmonizimin ndërkombëtar të metodave për përcaktimin e ngarkesës kritike dhe niveleve kritike dhe shtjellimin e procedurave për këtë harmonizim;

b) përmirësimin e teknikave monitoruese dhe sistemeve dhe të modelimit të transportit, përqendrimeve dhe depozitimit të përzierësve të sqfurit;

c) strategjitë për reduktimin e mëtejshëm të çlirimit të sqfurit bazuar në ngarkesat kritike dhe nivelet kritike, si dhe në zhvillimet teknike dhe përmirësimin e modelimit të vlerësimit të integruar për të llogaritur alokimet e përmirësuara në nivel ndërkombëtar të reduktimit të çlirimit, duke pasur parasysh një shpërndarje të njëjtë të kostove të pakësimit;

d) të kuptuarin e pasojave më të mëdha të çlirimit të sqfurit mbi shëndetin e njeriut, mjedisin, sidomos acidifikimin, dhe materialet, duke përfshirë monumente kulturore dhe historike, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet oksid sqfurit, oksid nitrogenit, amoniakut, përzierës organikë avullues dhe ozoni troposferik;

e) teknologji për pakësimin e çlirimit dhe teknologji e teknika për të përmirësuar efijencën e energjisë, konservimin e energjisë dhe përdorimin e energjisë së përsëritshme;

f) vlerësimin ekonomik të përfitimeve për mjedisin dhe shëndetin e njeriut që rezultojnë nga reduktimi i çlirimit të sqfurit.

## Neni 7

### **Zbatimi**

1. Një komitet zbatimi është krijuar për të rishikuar zbatimin e këtij protokolli dhe respektimin e detyrimeve nga palët. Ai i raporton palëve në seanca të organit ekzekutiv dhe mund të bëjë rekomandime që i konsideron të duhura.

2. Me shqyrtimin e një raporti dhe të rekomandimeve të Komitetit të Zbatimit, palët, duke pasur parasysh rrethanat e një çështjeje dhe në përputhje me praktikën e Konventës mund të vendosin dhe të kërkojnë për veprim që çon në zbatim të plotë të këtij protokollit, duke përfshirë masat për të ndihmuar zbatimin e protokollit nga një palë dhe për të çuar përpara objektivat e protokollit.

3. Palët, në seancën e parë të organit ekzekutiv pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit, miratojnë një vendim që përcakton strukturën dhe funksionet e Komitetit të Zbatimit, si dhe procedurat e rishikimit të zbatimit.

4. Përdorimi i procedurës së zbatimit nuk prek dispozitat e nenit 9 të këtij protokollit.

#### Neni 8

##### **Rishikimi nga palët në seancën e organit ekzekutiv**

1. Palët, në seanca të organit ekzekutiv, sipas nenit 10, paragrafit 2(a) të Konventës rishikojnë informacionin e siguruar nga palët dhe EMEP-i, të dhënat për pasojat e depozitimeve të sqfurit dhe përzierësve të tjerë acidifikues dhe raportet e Komitetit të Zbatimit të përmendur në nenin 7, paragrafi 1 të këtij protokollit.

2. a) Palët, në seancat e organit ekzekutiv, rishikojnë detyrimet e përcaktuara në këtë protokoll, duke përfshirë:

i) detyrimet e tyre në lidhje me alokimet e llogaritura dhe të përmirësuara në nivel ndërkombëtar të reduktimeve të çlirimit të përmendur në nenin 5, paragrafi 5; dhe

ii) përshtatshmërinë e detyrimeve dhe progresin e bërë drejt arritjes së objektivave të këtij protokollit;

b) rishikimi merr parasysh informacionin më të mirë shkencor në dispozicion për acidifikimin, duke përfshirë vlerësimet e ngarkesave kritike, zhvillimet teknologjike, kushte të ndryshueshme ekonomike dhe plotësimin e detyrimeve për nivelet e çlirimit;

c) në kuadër të këtyre shqyrtimeve, çdo palë, detyrimet e së cilës për tavanet e çlirimit të sqfurit sipas aneksit II nuk përputhen me alokimet e llogaritura dhe të përmirësuara në nivel ndërkombëtar të reduktimit të çlirimit për atë palë, të nevojshme për të reduktuar ndryshimin ndërmjet depozitimeve të sqfurit më 1990-ën dhe depozitimeve të sqfurit kritik brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-it me të paktën 60 për qind, bën çdo përpjekje për të marrë përsipër detyrimet e rishikuara;

d) procedurat, metodat dhe koha për këto rishikime specifikohet nga palët në një seancë të organit ekzekutiv. Rishikimi i parë i tillë përfundon më 1997-ën.

#### Neni 9

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve në lidhje me interpretimin ose aplikimin e këtij protokollit, palët e interesuara kërkojnë një zgjidhje të mosmarrëveshjes me anë të negociimit ose mjeteve të tjera paqësore të zgjedhura prej tyre. Palët në mosmarrëveshje njoftojnë organin ekzekutiv për mosmarrëveshjen e tyre.

2. Një palë që nuk është organizatë rajonale për integrim ekonomik, kur ratifikon, pranon, miraton apo aderon në këtë protokoll, ose në çdo kohë tjetër, mund të deklarojë në një dokument me shkrim paraqitur te depozituesi, që në lidhje me çdo mosmarrëveshje për interpretimin ose zbatimin e protokollit, pranon një ose të dyja mjetet e mëposhtme të zgjidhjes së mosmarrëveshjes si *ipso facto* të detyrueshme dhe pa marrëveshje, në lidhje me çdo palë që pranon të njëjtin detyrim:

a) paraqitja e mosmarrëveshjes te Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë;

b) arbitraritet në përputhje me procedurat për t'u miratuar nga palët në një seancë të organit ekzekutiv sa më shpejt që të jetë e mundur në një aneks për arbitrazhin.

Një palë që është organizatë rajonale e integritimit ekonomik mund të bëjë një deklaratë me efekt të ngjashëm në lidhje me arbitraritetin në përputhje me procedurat e përmendura në nënparagrafin (b) më sipër.

3. Një deklaratë e bërë sipas paragrafit 2 mbetet në fuqi derisa mbaron në përputhje me afatet e saj ose tre muaj pas depozitimit te depozituesi të njoftimit me shkrim të revokimit të saj.

4. Një deklaratë e re, një njoftim i revokimit ose mbarimi i një deklarate në asnjë mënyrë nuk prek procedimet përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose ndonjë gjykatë arbitrazhi, përvese kur palët bien dakord ndryshe.

5. Përveç rastit kur palët në një mosmarrëveshje kanë pranuar të njëjtat mjete të zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas paragrafit 2, nëse pas dymbëdhjetë muajve pas njoftimit nga një palë te tjetra që ka mosmarrëveshje ndërmjet tyre, palët e përfshira nuk kanë qenë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen me mënyrat e përmendura në nenin 1 më sipër, mosmarrëveshja paraqitet për pajtim, me kërkesë të njëres nga palët në mosmarrëveshje.

6. Për qëllim të paragrafit 5, krijohet një komision pajtimi. Komisioni përbëhet nga një numër i barabartë i anëtarëve të caktuar nga çdo palë e përfshirë ose, kur palët në pajtim ndajnë të njëjtin interes, nga grupi që ndan atë interes dhe një kryetar i zgjedhur bashkërisht nga anëtarët e emëruar. Komisioni jep një shpërblim rekomandues që palët e konsiderojnë në mirëbesim.

#### Neni 10

##### **Aneksë**

Aneksët e këtij protokollit janë pjesë e pandarë e protokollit. Aneksët I dhe IV kanë natyrë rekomanduese.

#### Neni 11

##### **Ndryshime dhe rregullime**

1. Çdo palë mund të propozojë ndryshime të këtij protokollit. Çdo palë e Konventës mund të propozojë një rregullim për aneksin II të këtij protokollit dhe të shtojë emrin e saj së bashku me nivelet e çlirimit, tavanet e çlirimit të sqfurit dhe përqindje të reduktimit të çlirimit.

2. Këto ndryshime dhe rregullime të propozuara i paraqiten me shkrim Sekretarit Ekzekutiv të Komisionit, që ia komunikon ato të gjitha palëve. Palët i diskutojnë ndryshimet dhe rregullimet e propozuara në seancën e radhës së organit ekzekutiv, me kusht që këto propozime të jenë qarkulluar nga Sekretari Ekzekutiv te palët të paktën nëntëdhjetë ditë më përpara.

3. Ndryshimet në këtë protokoll dhe anekset e tij II, III dhe V miratohen me konsensus të palëve të pranishme në një seancë të organit ekzekutiv dhe hyjnë në fuqi për palët që i kanë pranuar ato në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën dy të tretat e palëve i kanë depozituar instrumentet e pranimit te depozituesi. Ndryshimet hyjnë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën pala ka depozituar instrumentin e saj për pranimin e tyre.

4. Ndryshimet e anekseve të këtij protokollit, ndryshe nga ato të anekseve të përmendura në paragrafin 3 më sipër, miratohen me konsensus të palëve të pranishme në seancën e organit ekzekutiv. Me mbarimin e nëntëdhjetë ditëve nga data e komunikimit të tij nga Sekretari Ekzekutiv i Komisionit, një ndryshim në çdo aneks të tillë hyn në fuqi për ato palë që nuk kanë paraqitur te depozituesi një njoftim në përputhje me dispozitat e paragrafit 5 më poshtë, me kusht që të paktën gjashtëmbëdhjetë palë të mos kenë paraqitur një njoftim të tillë.

5. Çdo palë që nuk është në gjendje të miratojë një ndryshim për një aneks, të ndryshëm nga aneksi i përmendur në paragrafin 3 më sipër, njofton depozituesin me shkrim brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e komunikimit të miratimit të tij. Depozituesi pa vonesë njofton të gjitha palët për çdo njoftim të tillë që është marrë. Një palë në çdo kohë mund të zëvendësojë një miratim për njoftimin e mëparshëm dhe me depozitimin e një instrumenti pranimi te depozituesi ndryshimi i këtij aneksi hyn në fuqi për atë palë.

6. Ndryshimet në aneksin II miratohen me konsensus të palëve të pranishme në seancën e organit ekzekutiv dhe hyjnë në fuqi për të gjitha palët e këtij protokollit në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën Sekretari Ekzekutiv i Komisionit njofton palët me shkrim për miratimin e një ndryshimi.

#### Neni 12

##### **Nënshkrimi**

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim në Oslo më 14 qershor 1994, më pas në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 12 dhjetor 1994, nga shtetet anëtare të Komisionit, si dhe

shtetet që kanë status konsultativ në Komision, sipas paragrafit 8 të rezolutës 36 (IV) të Këshillit Ekonomik dhe Social të 28 marsit 1947, dhe nga organizata rajonale të integritit ekonomik, të përbëra nga shtete anëtare sovraane të Komisionit, që kanë kompetencë në lidhje me negociatat, përfundimet dhe aplikimet e marrëveshjeve ndërkombëtare në çështje të mbuluara nga protokollin aktual, me kusht që shtetet dhe organizatat e përfshira të jenë palë të Konventës dhe të jenë renditur në aneksin II.

2. Në çështje brenda kompetencës së tyre, këto organizata rajonale të integritit ekonomik, nga ana e tyre, ushtrojnë të drejtat dhe përbushin përgjegjësitë që u jep ky protokoll shteteve të tyre anëtare. Në këto raste, shtetet anëtare të këtyre organizatave nuk kanë të drejtë të ushtrojnë këto të drejta në mënyrë individuale.

#### Neni 13

#### **Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi**

1. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit nga palët nënshkruese.
2. Ky protokoll është i hapur për aderim që nga 12 dhjetori 1994 nga shtetet dhe organizatat që plotësojnë kërkesat e nenit 12, paragrafi 1.

#### Neni 14

#### **Depozituesi**

Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara që kryen funksionet e depozituesit.

#### Neni 15

#### **Hyrja në fuqi**

1. Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën instrumenti i gjashtëmbëdhjetë i ratifikimit, pranimi, miratimit apo aderimit është depozituar te depozituesi.
2. Për çdo shtet dhe organizatë të përmendur në nenin 12, paragrafi 1 që ratifikon, pranon ose miraton këtë protokoll, ose që aderon në të pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, protokollin hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga kjo palë e instrumenteve të saj të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.

#### Neni 16

#### **Tërheqja**

Në çdo kohë pas pesë vjetësh nga data në të cilën ky protokoll ka hyrë në fuqi në lidhje me një palë kontraktuese, ajo palë kontraktuese mund të tërhiqet nga ai duke dhënë një njoftim me shkrim te depozituesi. Çdo tërheqje e tillë hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes së tij nga depozituesi, ose në një datë që mund të specifikohet në njoftimin për tërheqjen.

#### Neni 17

#### **Tekste autentike**

Teksti origjinal i këtij protokollin, tekstet në anglisht, frëngjisht dhe rusisht të të cilit janë njëloj autentike, depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë protokoll. Bërë në Oslo, në ditën e katërbëdhjetë të qershorit, në një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër.



ANEKSI I DEPOZITIMI KRITIK I SQUFURIT  
(5 për qind në centigram të sqfurit për metër katror në vit)

	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38			
37							34	40	32	28	41	52	51	58	118	138	318	317	332											
36							38	39	32	32	34	34	31	34	112	138	608	434	332											
35							33	34	35	38	42	32	32	78	118	138	183	318												
34							34	25	33	33	41	34	33	100	122	448	228	238												
33							24	43	48	44	44	53	34	52	88	313	313	488												
32							38	28	48	73	78	81	48	38	32	82	243	238	378											
31				8	44	37	45	34	71	75	78	82	118	73	187	487	238	133	128	138	238	221	248	228						
30			8	4	30	42	60	37	55	85	80	88	128	102	128	388	338	278	143	138	288	173	171	173	208					
29			4	11	37	18	37	54	58	53	81	117	143	128	718	288	378	287	342	288	228	213	184	171	182					
28			14	8	8	35	18	40	28	81	71	117	111	132	228	323	348	378	228	283	343	177	187	291						
27			18	7	7	27	28	44	30	28	84	88	88	118	138	341	483	287	288	378	448	188	178	188						
26			32	18	18	28	18	34	28	25	187	81	188	188	128	284	211	333	418	271	251	234								
25			18	5	23	24	27	27	37	118	70	87	88	128	88	88	218	188	488	383	384	338								
24			18	8	24	31	55	35	182	148	87	84	138	148	83	102	211	178	418	384	228									
23			7	17	1	18	13	32	8	113	112	112	84	78	87	102	181	283	347	371	282									
22			13	5	14	11	20	28	38	45	77	78	78	121	114	128	184	188	231	388										
21			18	5	8	13	1	21	27	83	87	83	88	183	138	148	287	383	273	238										
20			74	17	2	20	3	11	85	118	78	81	116	131	138	183	244	87	88	183	283									
19			25		134	5	44	47	178	78	84	73	84	121	132	188	287	134	128	212	182	148	281							
18			30				51	8	33	75	83	118	178	187	177	117	84	218	178	183	188	232								
17			78	38	28			8	17	38	187	181	38	87	232	118	148	281	287	181	128	188								
16			72	47	70	187		43	43	30	41	51	88	83	184	138	137	142	178	124	133	118	188	188						
15			38	34	30	18	37	45	43	42	38	57	80	71	73	133	287	281	171	188	228	123	138	128	183	172	178			
14			18	78	58	83	188	82	78	133	48	58	84	32	84	238	184	228	383	372	187	181	128	141	182	188				
13			18	87	84	45	83	78	124	131	88	55	71	27	40	40	138	133	187	178	178									
12			48	78	188	113	82	188	88	88	65	68	70	72	78	87	171	283	282	288	148	184								
11			48	44		134	118	58	81	78	53	78	188	184	238	133	41				287	387								
10						183	112	117	188	83	72	137	123		131	138					121	232	228							
9							138	118	84	188					288	88	187					178								
8								218	181	137	137				181	188														
7								283	288	312	283	318	1887																	
6								188	282	188	184	188	223	1787	1818															
5								238	218	191	118	128	242	188	278															
4								288	137	187	124	173	332	248																
3								172	282	188	129	141	184	188																
2								278	138	134	124	142	284																	
1								88	78	43	78																			

**RREGULLIM I ANEKSIT II TË PROTOKOLLIT TË OSLOS 1994  
PËR REDUKTIMIN E MËTEJSHËM TË ÇLIRIMIT TË SQUFURIT  
ANEKSI II**

**TAVANET E ÇLIRIMIT TË SQUFURIT DHE PËRQINDJA E REDUKTIMIT TË ÇLIRIMIT  
(NDRYSHUAR NË DHJETOR 2004)**

Tavanet e çlirimit të sqfurit të renditura në tabelën më poshtë japin detyrimet e përmendura në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 2 të këtij protokoll. Nivelet e çlirimit të 1980-ës dhe 1990-ës dhe përqindja e reduktimit të çlirimit e renditur më poshtë jepet vetëm për qëllime informacioni.

	Nivele të çlirimit kt SO <sub>2</sub> në vit		Tavane të çlirimit të sqfurit a/kt SO <sub>2</sub> në vit			Përqindje të reduktimit të çlirimit (viti bazë 1980)b/		
	1980	1990	2000	2005	2010	2000	2005	2010
Austri	397	90	78			80		
Bjellorusi	740		456	400	370	38	46	50
Belgjikë	828	443	248	232	215	70	72	74
Bullgari	2 050	2 020	1 374	1 230	1 127	33	40	45
Kanada								
- kombëtare	4614	3700	3 200			30		
- SOMA	3245		1 750			46		
Kroaci	150	160	133	125	117	11	17	22
Qipro e/	28	46	53	48	39	0	9	26
Republika Çeke	2 257	1 876	1 128	902	632	50	60	72
Danimarkë	451	180	90			80		
Finlandë	584	260	116			80		
Francë	3 348	1 202	868	707	737	74	77	78
Gjermani	7 494	5 803	1 300	990		83	87	
Greqi	400	510	595	580	570	0	3	4
Hungari	1 632	1 010	898	816	653	45	50	60
Irlandë	222	168	155			30		
Itali	3 800		1 330	1 042		65	73	
Lihtenshtejn	0.4	0.1	0.1			75		
Luksemburg	24		10			58		
Monako d/	0.08	0.07	0.07	0.05	0.04	13	38	50
Holandë	466	207	106			77		
Norvegji	142	54	34			76		
Poloni	4 100	3 210	2 583	2 173	1 397	37	47	66
Portugali	266	284	304	294		0	3	
Federata Ruse c/ Sllovaki	7161	4 460	4 440	4 297	4297	38	40	40
Slloveni	843	539	337	295	240	60	65	72
Spanjë	235	195	130	94	71	45	60	70
Suedi	3319	2 316	2 143			35		
Zvicër	507	130	100			80		
Ukrainë	126	62	60			52		
Mbretëri e Bashkuar	3 850		2 310			40		
Komunitet European	4898	3 780	2 449	1470	980	50	70	80
	25513		9 598			62		

**Shënime**

a/ Nëse në një vit të dhënë përpara 2005-ës, një palë gjen që, për shkak të një dimri veçanërisht të ftohtë, një vere veçanërisht të thatë dhe një humbjeje afatshkurtër të paparashikuar të kapacitetit në sistemin e furnizimit të energjisë, në vend dhe në një vend fqinjë, nuk mund të plotësojë detyrimet e saj sipas këtij aneksi, mund të përmbushë ato detyrime, duke pasur në nivel mesatar çlirimet vjetore kombëtare të sqfurit për vitin në fjalë, vitin që i paraprin atij viti dhe që vijon pas tij, me kusht që nivelet e çlirimit në çdo vit të mos jenë më shumë se 20% mbi tavanin e çlirimit të sqfurit.

Arsyeja e tejkalimit në një vit të caktuar dhe metoda me të cilën shifra mesatare e tre viteve do të arrihet, i raportohet Komitetit të Zbatimit.

b/ Për Greqinë, Qipron dhe Portugalinë, përqindje të reduktimit të çlirimit të dhëna janë bazuar në tavanet e çlirimit të sqfurit të treguara për vitin 2000.

c/ Pjesa europiane brenda zonës EMEP.

d/ Shifra për Monakon të miratuara në seancën e nëntëmbëdhjetë të organit ekzekutiv.

e/ Shifrat për Qipron të miratuara në seancën e njëzetedytë të organit ekzekutiv.

### ANEKSI III

#### PËRCAKTIMI I ZONAVE TË MENAXHIMIT TË OKSID SQUFURIT (SOMAs) SOMA TË MËPOSHTME JANË RENDITUR PËR QËLLIME TË KËTIJ PROTOKOLLI: SOMA, KANADA JUGLINDORE

Kjo është një zonë 1 milion km<sup>2</sup> që përfshin gjithë territorin e provincave të ishullit Prince Edward, Nova Scotia dhe New Brunswick, gjithë territorin e provincës së Kebekut Jugor të një vije të drejtë ndërmjet Havre-St.Pierre në bregun verior të Gjirit të Saint Lawrence dhe pikës ku kufiri Quebec-Ontario ndërpritet me vijën bregdetare James Bay dhe gjithë territorin e provincës së Ontario Jugor të një linje të drejtë ndërmjet pikës ku kufiri Ontario-Kebel ndërpritet me vijën bregdetare James Bay dhe lumin Nipigon afër bregut verior të Lake Superior.

### ANEKSI IV

#### TEKNOLOGJI KONTROLLI PËR ÇLIRIMIN E SQUFURIT NGA BURIME TË PALËVIZSHME

##### I. HYRJE

1. Qëllimi i këtij aneksi është të japë udhëzime për identifikimin e mundësive të kontrollit të sqfurit dhe teknologjive për të fuqizuar detyrimet e këtij protokollit.

2. Aneksi bazohet në informacion për mundësi të përgjithshme për reduktimin e çlirimit të sqfurit dhe në veçanti për performancën e teknologjisë së kontrollit të çlirimit dhe kostos që përmban dokumentacioni zyrtar i organit ekzekutiv dhe organe të tij të varësisë.

3. Përveçse kur tregohet ndryshe, masat e reduktimit të renditura, konsiderohen në bazë të përvojës operacionale të shumë viteve në shumë raste, teknologjitë më të mira praktike nga aspekti ekonomik dhe më të mirëpërcaktuara. Megjithatë, përvoja vazhdimisht e përhapur e masave për çlirimin e pakët dhe teknologjive në impiante të reja, si dhe për ripajisjen e impianteve ekzistuese do të bëjë të nevojshëm rishikimin e rregullt të këtij aneksi.

4. Edhe pse aneksi rendit disa masa dhe teknologji që përfshijnë një gamë të gjerë të kostove dhe efiçencës, nuk mund të konsiderohet një deklaratë shteruese e mundësive të kontrollit. Gjithashtu, zgjedhja e masave të kontrollit dhe teknologjisë për çdo rast të veçantë varet nga një sërë faktorësh, duke përfshirë legjislacionin aktual dhe dispozitat rregullatore dhe në veçanti, kërkesa të teknologjisë së kontrollit, modele të energjisë parësore, infrastrukturë industriale, rrethana ekonomike dhe kushte specifike në impiant.

5. Aneksi trajton kryesisht kontrollin e çlirimit të sqfurit të oksiduar të konsideruar si shuma e dyoksid sqfurit (SO<sub>2</sub>) dhe trioksid sqfurit (SO<sub>3</sub>), të shprehur si SO<sub>2</sub>. Pjesa e sqfurit të çliruar ose si oksid sqfuri ose si përbërës tjetër sqfuri nga procese jodjegjeje dhe burime të tjera, është e vogël krahasuar me çlirimin e sqfurit nga djegia.

6. Kur masa ose teknologji planifikohen për burimet e sqfurit që çlirojnë përbërës të tjerë, sidomos oksid nitrogjeni (NO<sub>x</sub>), grimca, metale të rënda dhe përbërës organikë avullues (VOCs), ia vlen të konsiderohen ato në lidhje me mundësi kontrolli të ndotësve specifike, për të maksimizuar efektin e përgjithshëm të pakësimit dhe për të minimizuar ndikimin mbi mjedisin dhe, sidomos për të shmangur transferimin e problemeve të ndotjes së ajrit në mënyra të tjera (siç janë ujërat e ndotura dhe mbetjet e ngurta).

##### II. BURIME KRYESORE TË QËNDRUESHME PËR ÇLIRIMIN E SQUFURIT

7. Procese të djegies së lëndëve djegëse fosile janë burimi kryesor i çlirimit të sqfurit antropogjenik nga burime të palëvizshme. Gjithashtu, disa procese jo të djegies mund të kontribuojnë

ndjeshëm të çlirimi. Kategoritë kryesore të burimit të palëvizshëm, bazuar në EMEP/CORINAIR 90, përfshijnë:

- i) Impiante energjie, energjie dhe ngrohjeje dhe ngrohjeje:
  - a) bolierë;
  - b) turbina të palëvizshme të djegies dhe motorë të brendshëm të djegies.
- ii) Impiante djegieje komerciale, institucionale dhe rezidenciale:
  - a) ngrohës-bolierë komercialë;
  - b) ngrohës shtëpiakë.
- iii) Impiante industriale të djegies dhe procese me djegie:
  - a) bolierë dhe ngrohës;
  - b) procese, p.sh.: veprimtari metalurgjike siç janë kalcinimi dhe skorie përpunimi, impiante me furra koksifikimi, përpunimi i dyoksid titaniumit (TiO<sub>2</sub>) etj.;
  - c) prodhim palce.
- iv) Procese jo me djegie, p.sh.: prodhim i acidit squfurik, procese të sintezës organike specifike, trajtimi i sipërfaqeve metalike.
- v) Nxjerrja, përpunimi dhe shpërndarja e lëndëve djegëse fosile.
- vi) Trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve, p.sh.: trajtimi termik i mbetjeve industriale dhe bashkiake.

8. Të dhëna të përgjithshme (1990) për rajonin ECE tregojnë që rreth 80% e çlirimit total të squfurit e ka origjinën nga gjithë proceset e djegies (20 për qind nga djegia industriale), 5 për qind nga procese prodhimi dhe 7 për qind nga rafineri naftë. Sektori i centralit elektrik në shumë vende është kontribuuesi i vetëm kryesor i çlirimit të squfurit. Në disa vende, sektori industrial (duke përfshirë rafineritë) është, gjithashtu, një çlirues i rëndësishëm i SO<sub>2</sub>. Edhe pse çlirimi nga rafineritë në rajonin ECE është relativisht i vogël, ndikimi i tyre mbi çlirimin e squfurit nga burime të tjera është i madh për shkak të squfurit në produkte naftë. 60 për qind e kapacitetit të squfurit të pranishëm në lëndë të para mbetet në produkte, 30% rikuperohet si squfur elementar dhe 10 për qind çlirohet nga gypa rafinerie.

### III. MUNDËSI TË PËRGJITHSHME PËR REDUKTIMIN E ÇLIRIMIT TË SQUFURIT NGA DJEGIA

9. Mundësi të përgjithshme për reduktimin e çlirimit të squfurit janë:

i) Masa të menaxhimit të energjisë<sup>1</sup>:

a) Kursim energjie

Përdorimi racional i energjisë (efiçencë e përmirësuar e energjisë/funksionim i procesit, gjenerimit të nxehtësisë dhe energjisë dhe/ose menaxhimi nga ana e kërkesës) zakonisht rezulton në reduktim të çlirimit të squfurit.

b) Përzierje energjie

Në përgjithësi, çlirimi i squfurit mund të reduktohet duke rritur pjesën e burimeve të energjisë pa djegie (i.e. hidro, nukleare, erës etj.) në përzierjen e energjisë. Megjithatë, duhet të konsiderohen ndikime të mëtejshme mjedisore.

ii) Mundësi teknologjike:

a) Ndryshim lëndë djegëse

Çlirimi i SO<sub>2</sub> gjatë djegies lidhet direkt me përmbajtjen e squfurit në lëndën djegëse të përdorur.

Ndryshim i lëndës djegëse (p.sh. qymyri dhe/ose lëndë djegëse të lëngshme nga përmbajtje e lartë në të ulët të squfurit) çon në çlirim më të ulët të squfurit, por mund të ketë disa kufizime, siç janë mundësia për të pasur lëndë djegëse më përmbajtje të ulët squfuri dhe përshtatshmëria e sistemeve ekzistuese të djegies me lëndë të ndryshme djegëse. Në shumë vende ECE, impiante të djegies të qymyrit apo gazoilut po zëvendësohen me impiante të djegies të ndezura me gaz. Impiante me dy lëndë djegëse mund të lehtësojnë ndryshimin e lëndës djegëse.

b) Pastrim i lëndës djegëse

Pastrimi i gazit natyror është i teknologjisë së fundit dhe gjerësisht i përdorur për arsye operacionale.

---

<sup>1</sup> Opsionet (i) (a) dhe (b) janë të integruara në strukturën e energjisë dhe politikën e një pale. Statusi i zbatimit, efiçenca dhe kostot për sektor nuk konsiderohen këtu.

Pastrimi i gazit të procesit (gaz i rafinerisë, gaz i furrës së koksifikimit, biogas etj.) është, gjithashtu, i teknologjisë së fundit.

Desqfurizimi i lëndëve djegëse (fraksione të lehta dhe të mesme) është teknologji më e fundit.

Desqfurizimi i fraksioneve të rënda teknikisht është i mundur, pavarësisht kësaj, duhet të mbahen parasysh veçoritë e lëndës së parë. Desqfurizimi i mbetjeve atmosferike (produkte fundore nga njësi të distilimit të lëndës së papërpunuar atmosferike) për prodhimin e gazoilit me përmbajtje të ulët sqfuri nuk është gjerësisht i praktikuar; zakonisht preferohet përpunimi i lëndës së papërpunuar me përmbajtje të ulët sqfuri. Procesi i ndarjes së molekulave hidrokarbon të gazoilit ndahen në molekula më të thjeshta dhe teknologji me konvertim të plotë janë maturuar dhe kombinon mbajtjen me përmbajtje të lartë sqfuri me epshmëri të përmirësuar të produkteve të lehta. Numri i rafinerive të konvertimit të plotë është i kufizuar. Këto rafineri rikuperojnë 80 deri në 90 për qind të marrjes së sqfurit dhe i kthejnë të gjitha mbetjet në produkte të lehta ose produkte të tjera të tregtueshme. Për këtë lloj rafinerie, kostot e investimit dhe konsumit të energjisë rriten. Përmbajtja tipike e sqfurit për produkte rafinerie jepet në tabelën 1.

Teknologjitë aktuale për të pastruar qymyrin e fortë mund të heqin përafërsisht 50 për qind të sqfurit inorganik (në varësi të veçorive të qymyrit), por aspak sqfur organik. Teknologji më të efektshme po zhvillohen, që përfshijnë më shumë investime specifike dhe kosto. Kështu, eficienta e heqjes së sqfurit nga pastrimi i qymyrit është e kufizuar krahasuar me desqfurizim të gaz tymit. Mund të jetë një mundësi optimizmi specifike për një vend për kombinim më të mirë të pastrimit të lëndës djegëse dhe pastrimit të gaz tymit.

#### PËRMBAJTA E SQFURIT NGA PRODUKTE RAFINERIE (PËRMBAJTJA S (PËR QIND))

	Vlera tipike e pranishme	Vlera të parashikuara në të ardhmen
Benzinë.....	0.1	0.05
Vajgur .....	0.1	0.01
Gazoil.....	0.05-0.3	< 0.05
Gazoil për ngrohje.....	0.1-0.2	< 0.1
Gazoil (lëndë djegëse)....	0.2-3.5	< 1
Gazoil detar.....	0.5-1.0	< 0.5
Vaj bunkerier.....	3.0-5.0	< 1 (zona bregdetare)
		< 2 (det të hapur)

#### c) Teknologji të avancuara të djegies

Këto teknologji djegieje me eficientë të përmirësuar termike dhe çlirim të reduktuar të sqfurit përfshijnë: djegie në shtrat të fluidizuar (FBC): fluskuese (BFBC), qarkulluese (CFBC) dhe me presion (PFBC); ciklin e kombinuar të integruar të gazifikimit (IGCC); dhe turbina gazi me cikël të kombinuar (CCGT).

Turbina të palëvizshme të djegies mund të integrohen në sisteme të djegies në centrale elektrike ekzistuese që mund të rritin eficientën e përgjithshme me 5 deri në 7 për qind, duke çuar, për shembull, në reduktim të rëndësishëm të çlirimit të SO<sub>2</sub>. Megjithatë, alterime të mëdha të sistemit ekzistues të furrave bëhen të nevojshme.

Djegje në shtrat të fluidizuar (FBC) është teknologji djegieje për djegien e antracitit dhe linjtit, por mund të djegë dhe lëndë të tjera djegëse të ngurta, siç janë koks naftë dhe lëndë djegëse me gradë të ulët, siç janë mbetjet, torfë dhe druri. Çlirimi, gjithashtu, mund të reduktohet me anë të kontrollit të integruar të djegies në sistem për shkak të shtimit të gëlqere/gur gëlqeror në material. Kapaciteti i plotë të FBC ka arritur përafërsisht 30,000 MWth (250 deri në 350 impiante), duke përfshirë 8,000 MWthin, kapaciteti më shumë se 50 MWth. Nënprodukte nga ky proces mund të shkaktojnë probleme në lidhje me përdorimin dhe/ose depozitimin, dhe kërkohet zhvillim i mëtejshëm.

Procesi IGCC përfshin gazifikimin e qymyrit dhe gjenerimin e energjisë në cikël të kombinuar në një turbinë gazi dhe avulli. Qymyri i gazifikuar digjet në dhomën e djegies së turbinës së gazit. Kontrolli i çlirimit të sqfurit arrihet nga përdorimi i teknologjisë moderne për ambiente të pastrimit të

gazit të papërpunuar të turbinës së gazit. Teknologjia ekziston, gjithashtu, për mbetje të vajit të rëndë dhe emulsione bitumi. Kapaciteti është aktualisht rreth 1,000 MWel (5 impiante).

Centralë elektrike me turbinë gazi me cikël të kombinuar që përdorin gazin natyror si lëndë djegëse me efikasitet energjie përafërsisht 48 deri në 52 për qind po planifikohen aktualisht.

d) Procesi dhe modifikime të djegies

Modifikime të djegies të krahasueshme me masat e përdorura për kontrollin e çlirimit të Nox nuk ekzistojnë, pasi gjatë djegies së squfurit organik dhe/ose inorganik është pothuajse i oksiduar (një përqindje e caktuar në varësi të veçorive dhe teknologjisë së djegies mbahet në hi).

Në këtë aneks procese me shtues të thatë për bolierë konvencionalë konsiderohen si modifikime të procesit për shkak të injektimit të një agjenti në njësinë e djegies. Megjithatë, përvoja ka treguar që, kur aplikohen këto procese, kapaciteti termik ulet, raporti Ca/S është i lartë dhe heqja e squfurit e ulët. Probleme me përdorimin e mëtejshëm të nënproduktit duhet të konsiderohen, në mënyrë që kjo zgjidhje të zbatohet zakonisht si masë e ndërmjetme dhe për njësi më të vogla (tabela 2).

e) Procese të desqufurimit të gaz timit (FGD)

Këto procese synojnë të heqin oksid squfurin tashmë të krijuar dhe njihen, gjithashtu, si masa dytësore. Teknologjitë moderne për procese të trajtimit të gaz timit bazohen të gjitha në heqjen e squfurit me anë të proceseve kimike kataliktike dhe të thata ose gjysmë të thata.

Për të arritur programin më të efektshëm për reduktime të çlirimit të squfurit përtej masave të menaxhimit të energjisë të renditura në (i) më sipër, duhet të konsiderohet një kombinim i mundësive teknologjike të identifikuar në (ii) më sipër.

Në disa raste, mundësitë për të reduktuar çlirimin e squfurit mund të rezultojnë, gjithashtu, në reduktimin e çlirimit të CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe ndotësve të tjerë.

Në impiante energjie, energjie dhe ngrohjeje dhe ngrohjeje, proceset e trajtimit të gaz timit përfshijnë: fërkim në të njomë të gëlqeres/gurit gëlqeror (LWS); absorbim i thatë i spërklave (SDA); procesin Wellman Lord (WL); fërkim i amoniakut (AS); dhe procese të heqjes së NO<sub>x</sub>/SO<sub>x</sub> të kombinuara (proces i karbonit të aktivizuar (AC) dhe heqje e kombinuar kataliktike e NO<sub>x</sub>/SO<sub>x</sub>).

Në sektorin e gjenerimit të fuqisë, LWS dhe SDA mbulojnë 85 për qind dhe 10 për qind përkatësisht të kapacitetit të FGD.

Disa procese të reja të desqufurizimit të gaz timit, siç janë fërkim i thatë me rreze elektroni (EBDS) dhe Mark 13A, nuk e kanë kaluar akoma fazën pilot.

Tabela 2 tregon efikasitetin e masave të mësipërme dytësore bazuar në përvojën praktike të fituar nga një numër i madh i impianteve. Kapaciteti i zbatuar, si dhe gama e kapacitetit përmenden gjithashtu. Përveç karakteristikave të krahasueshme për disa teknologji të pakësimit të squfurit, ndikime lokale ose specifike të një impianti mund të çojnë në përjashtimin e një teknologjie të caktuar.

Tabela 2, gjithashtu, përfshin koston e zakonshme të investimit për teknologjitë për pakësimin e squfurit të renditur në seksionet (ii) (c), (d) dhe (e). Megjithatë, në zbatimin e këtyre teknologjive për raste të veçanta, duhet theksuar që kosto të investimit për masa për reduktimin e çlirimit do të varen mes të tjerash në teknologjitë e veçanta të përdorura, sistemet e kërkuara të kontrollit, madhësinë e impiantit, shtrirjen e reduktimit të kërkuar dhe shtrirjen kohore të cikleve të planifikuara të mirëmbajtjes. Kështu, tabela jep vetëm një gamë të gjerë të kostove të investimit. Kostot e investimit për ripajisje përgjithësisht tejkalojnë ato për impiante të reja.

**TABELA 2**  
**ÇLIRIMI I OKSID SQUFURIT I SIGURUAR NGA APLIKIMI I MUNDËSIVE TEKNOLOGJIKE**  
**PËR BOLIERË ME LËNDË DJEGËSE FOSILE**

	<b>Çlirim i pakontrolluar</b>	<b>Injeksion shtesë</b>	<b>Fërkim i njomë a</b>	<b>Absorbim i thatë i spërklave b</b>
Efiçenca e reduktimit (%)		deri në 60	95	deri në 90
Efiçenca e energjisë		0.1-1	6-10	3-6
			194.000	16.000
Lloji i nënproduktit		Miks i kripërave Ca dhe hir i lehtë	Gips (llum/ujë kanalizimesh)	Miks i CaSO <sub>3</sub> * 172 H <sub>2</sub> O dhe hir i lehtë
Investimet specifike		20-50	60-250	50-220
	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel
Antracit d	1000-10000 3.5-35	400-40000 1.4-14	< 400 < 1.4	< 400 < 1.4
			(< 200, 1 % S) < 0.7	(< 200, 1 % S) < 0.7
Linjit d	1000-20000 4.2-84	400-8000 1.7-33.6	< 400 < 1.7	< 400 < 1.7
			(< 200, 1 % S) < 0.8	(< 200, 1 % S) < 0.8
Vaj i rëndë d	1000-10000 2.8-28	400-4000 1.1-11	< 400 < 1.1	< 400 < 1.1
			(< 200, 1 % S) < 0.6	(< 200, 1 % S) < 0.6
	Fërkim amoniaku b	Wellman Lord a	Karbon i aktivizuar a	Katalitiku i kombinuar a
Efiçenca e reduktimit (%)	Deri në 90	95	95	95
Efiçenca e energjisë (kWel/103m <sup>3</sup> /h)	3-10	10-15	4-8	2
Kapaciteti total i instaluar (ECE Eur) (MWth)	200	2000	700	1300
Lloji i nënproduktit	Fertilizues amoniaku	Element S	Element S	Acid sqfurik (70 ët %)
		Acid sqfurik (90 vol %)	Acid sqfurik (99 vol %)	
Investim specifik (kosto ECU 1990(kWel))	230-270 e	200-300 e	280-320 e f	320-350 e f
	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel	mg/m <sup>3</sup> c g/kWhel
Antracit d	< 400 < 1.4	< 400 < 1.4	< 400 < 1.4	< 400 < 1.4
	(< 200, 1 % S) < 0.7	(< 200, 1 % S) < 0.7	(< 200, 1 % S) < 0.7	(< 200, 1 % S) < 0.7
Linjit d	< 400 < 1.7	< 400 < 1.7	< 400 < 1.7	< 400 < 1.7
	(< 200, 1 % S) < 0.8	(< 200, 1 % S) < 0.8	(< 200, 1 % S) < 0.8	(< 200, 1 % S) < 0.8
Vaj i rëndë d	< 400 < 1.1	< 400 < 1.1	< 400 < 1.1	< 400 < 1.1
	(< 200, 1 % S) < 0.6	(< 200, 1 % S) < 0.6	(< 200, 1 % S) < 0.6	(< 200, 1 % S) < 0.6

a) Efiçenca e heqjes duhet të përshtatet për përmbajtjen e lartë të sqfurit në lëndë djegëse. Megjithatë, qëllimi për të bërë këtë mund të jetë specifik për procesin. Disponueshmëria e këtyre proceseve zakonisht është 95%.

b) Zbatueshmëri e kufizuar për lëndë djegëse me përmbajtje të lartë të sqfurit.

c) Çlirim në mg/m<sup>3</sup> (STP), i thatë, 6% oksigjen për lëndë djegëse të ngurta, 3% oksigjen për lëndë djegëse të lëngshme.

d) Faktori i konvertimit varet nga veçoritë e lëndës djegëse, vëllimi specifik i gaz tymit dhe efiçenca termike e bolierëve (faktorë konvertimi (m<sup>3</sup>/kWhel, efiçenca termike: 36%) të përdorur: antracit: 3.50; linjit: 4.20; vaj i rëndë: 2.80).

e) Kosto specifike investimi lidhet me një kampion të vogël të instalimeve.

f) Kosto specifike investimi përfshin procesin e denitrifikimit.

Tabela u krijua kryesisht për instalime të mëdha të djegies në sektorin publik. Megjithatë, mundësitë e kontrollit janë, gjithashtu, të vlefshme për sektorë të tjerë me gazra të ngjashme të shkarkuara.

#### IV. TEKNIKA KONTROLLI PËR SEKTORË TË TJERË

10. Teknikat e kontrollit të renditura në seksionin 9 (ii) (a) deri në (e) janë të vlefshme jo vetëm në sektorin e centralit elektrik, por dhe në sektorë të tjerë të industrisë. Shumë vite të përvojës operationale janë fituar, në shumicën e rasteve, në sektorin e centralit elektrik.

11. Aplikimi i teknologjive të pakësimit të sqfurit në sektorin industrial varet vetëm nga kufizime specifike të procesit në sektorët e rëndësishëm. Kontribues të rëndësishëm për çlirimin e sqfurit dhe masa korresponduese të reduktimit janë paraqitur në tabelën 3 më poshtë.

12. Në sektorët e renditur në tabelën 3, masa të integruara në proces, duke përfshirë ndryshime të materialit të parë (nëse është e nevojshme të kombinuara me trajtimin specifik të gaz tymit) mund të përdoren për të arritur reduktimin më të efektshëm të çlirimit të sqfurit.

TABELA 3

Burimi	Masa të reduktimit
Pjekja e sulfideve joferroze	Proces katalizues i acidit sqfurik (WSA)
Prodhim viskoze	Proces me kontakt të dyfishtë
Prodhim acidi sqfurik	Procesi me kontakt të dyfishtë, eptshmëri e përmirësuar
Prodhim i palcës kraft	Larmia e masave të integruara të procesit

13. Shembuj të raportuar janë si më poshtë:

a) Në fabrika të reja të palcës kraft, çlirimi i sqfurit më pak se 1 kg sqfur për tonë palcë AD (i tharë në ajër) mund të arrihet;\*\*

b) Në fabrika të palcës suflite, 1 deri në 1.5 kg sqfur për tonë palcë AD mund të arrihet;

c) Në rastin e pjekjes së sulfideve, eficaenca të heqjes të 80 deri në 99% për 10,000 deri në 200,000 m<sup>3</sup>/h njësi janë raportuar (në varësi të procesit);

d) Për një impiant algomerues për xeheror, një njësi FGD me kapacitet 320,000 m<sup>3</sup>/h arrin një vlerë të gazit të pastër nën 100 mg SO<sub>x</sub> /Nm<sup>3</sup> në 6 për qind O<sub>2</sub>;

e) Furrat e koksifikimit arrijnë më pak se 400 mg SO<sub>x</sub>/Nm<sup>3</sup> në 6 për qind O<sub>2</sub>;

f) Impiante të acidit sqfurik arrijnë një normë konvertimi më të madhe se 99 për qind;

g) Impiant i avancuar Claus arrin rikuperim të sqfurit më shumë se 99 për qind.

#### V. NËNPRODUKTET DHE EFEKTET ANËSORE

14. Ndërsa rriten përpjekjet për të reduktuar çlirimin e sqfurit nga burime të palëvizshme në vendet e rajonit ECE, do të rriten, gjithashtu, sasitë e nënprodukteve.

15. Duhet të përzgjidhen opsione që do të çonin në nënprodukte të përdorshme. Gjithashtu, opsione që çojnë në eficaencë të rritur termike dhe që minimizojnë çështje të depozitimit përfundimtar të mbetjeve kur është e mundur duhet të përzgjidhen. Edhe pse shumica e nënprodukteve janë të përdorshme ose të riciklueshme, siç janë: gipsi, kripëra amoniaku, acidi sqfurik ose sqfuri, faktorë si kushtet e tregut dhe standarde të cilësisë duhet të merren parasysh.

Përdorimi i mëtejshëm i nënprodukteve FBC dhe SDA duhet të përmirësohen dhe të hetohen, pasi vende të depozitimit dhe kritere të depozitimit kufizojnë depozitimin në vende të ndryshme.

16. Efektet e mëposhtme anësore nuk parandalojnë zbatimin e ndonjë teknologjie apo metode, por duhet të konsiderohen kur janë të mundura disa mundësi të pakësimit të sqfurit:

a) kërkesat e energjisë të proceseve të trajtimit të gazit;

b) korrozion për shkak të formimit të acidit sqfurik nga reaksioni i oksid sqfurit me avull uji;

c) përdorim i rritur i ujit dhe trajtimi i ujërave të kanalizimeve;

\*\* Kërkohet kontrolli i raportit sqfur-sodium, pra heqja e sqfurit në formën e kripërave neutrale dhe përdorimi i përbërjes me sqfur pa sodium.



- d) kërkesat e reagjentit;
- e) depozitim i mbetjeve të ngurta.

## VI. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

17. Masat e marra për të realizuar strategjitë dhe politikat kombëtare për pakësimin e ndotjes së ajrit përfshijnë: legjislacion dhe dispozita rregullatore, shtysa dhe jo shtysa ekonomike, si dhe kërkesa teknologjike (teknologjia më e mirë në dispozicion).

18. Në përgjithësi, standardet janë caktuar për burim çlirimi sipas madhësisë së impiantit, mënyrës së funksionimit, teknologjisë së djegies, llojit të lëndës djegëse dhe nëse impianti është i ri apo ekzistues. Një metodë alternative e përdorur, gjithashtu, është vendosja e një objekti për reduktimin e çlirimit total të squfurit nga një grup burimesh dhe mundësimi i një zgjedhjeje për të ndërmarrë veprim për të arritur këtë objektiv (koncepti flluskë).

19. Përpjekje për të kufizuar çlirimin e squfurit në nivelet e përcaktuara në legjislacionin kuadër kombëtar duhet të kontrollohen nga një sistem i përhershëm monitorimi dhe raportimi dhe t'i raportohen autoriteteve mbikëqyrëse.

20. Disa sisteme monitorimi, që përdorin metoda matjeje të vazhdueshme dhe jo të vazhdueshme janë në dispozicion. Megjithatë, kërkesat e cilësisë janë të ndryshme. Matjet bëhen nga institute të kualifikuara duke përdorur sisteme matjeje dhe monitorimi. Për këtë qëllim, një sistem certifikimi mund të japë sigurinë më të mirë.

21. Në kuadër të sistemeve moderne automatike të monitorimit dhe pajisjeve të kontrollit të procesit, raportimi nuk krijon problem. Mbledhja e të dhënave për përdorim të mëtejshëm është teknikë moderne; megjithatë, të dhënat që u raportohen autoriteteve kompetente ndryshojnë nga rasti në rast. Për të siguruar krahasueshmëri më të mirë, të dhënat dhe rregullat përshkruese duhet të harmonizohen. Harmonizimi është, gjithashtu, i dëshirueshëm për sigurim cilësie të sistemeve të matjes dhe monitorimit. Kjo duhet të merret parasysh në krahasimin e të dhënave.

22. Për të shmangur mospërputhjet dhe mungesën e konsistencës, çështje dhe parametra kryesorë, duke përfshirë sa më poshtë, duhet të jenë të mirëpërcaktuara:

a) përkufizimi i standardeve të shprehur, si: ppmv, mg/Nm<sup>3</sup>, g/GJ, kg/h ose kg/tonë i produktit. Shumica e këtyre njësive duhet të llogariten dhe kërkojnë specifikime për sa i përket temperaturës së gazit, lagështisë, trysnia, përmbajtja e oksigjenit apo vlera e inputit të nxehtësisë;

b) përcaktimi i periudhës gjatë së cilës standardet duhet të jenë mesatare, e shprehur në orë, muaj apo një vit;

c) përcaktimi i kohëve të mosfunksionimit dhe rregullave përkatëse të rasteve të urgjencës në lidhje me shmangien e sistemeve të monitorimit apo mbylljen e instalimit;

d) përcaktimi i metodave për plotësimin e të dhënave të munguara apo të humbura si rezultat i mosfunksionimit të pajisjeve;

e) përcaktimi i parametrave të caktuar për t'u matur. Sipas llojit të procesit industrial, informacioni i nevojshëm mund të ndryshojë. Ky përfshin, gjithashtu, vendndodhjen e pikës së matjes brenda sistemit.

23. Duhet të sigurohet kontrolli i cilësisë së matjeve.

**ANEKSI V**  
**VLERAT KUFIT TË ÇLIRIMIT DHE PËRMBAJTJES SË SQUFURIT**

<b>A. Vlerat kufi të çlirimit për burime të palëvizshme të djegies a</b>			
	i) (MWth)	ii) Vlera kufi e çlirimit (mg SO <sub>2</sub> /Nm <sup>3</sup> b)	iii) Norma e desqfurizimit (për qind)
1. LËNDË DJEGËSE TË NGURTA (bazuar në 6 për qind oksigjen në gaz tym)	50-100 100-500 > 500	2 000 2 000-400 (rënie lineare) 400	40 (për 100-167 MWth) 40-90 (rritje lineare për 167-500 MWth) 90
2. LËNDË DJEGËSE TË LËNGSHME (bazuar në 3 për qind oksigjen gaz tym)	50-300 300-500 > 500	1 700 1 700-400 (rënie lineare) 400	90 90
3. LËNDË DJEGËSE TË GAZTA (bazuar në 3 për qind oksigjen në gaz tym)			
Lëndë djegëse të gazta në përgjithësi		35	
Gaz i lëngshëm		5	
Gaz pak kalorifik nga gazifikimi i mbetjeve të rafinerisë, gaz për furra koksifikimi, gaz për furra me fryrje		800	

<b>B. Gazoil</b>	<b>Përmbajtja e sqfurit (përqindje)</b>
Gazoil për automjetet në qarkullim	0.05
Lloje të tjera	0.2

<sup>a)</sup> Si udhëzim, për një impiant me njësi që ndizet me shumë lëndë djegëse, duke përfshirë përdorimin e njëkohshëm të një ose më shumë lëndëve djegëse, autoritetet kompetente përcaktojnë vlera kufi të çlirimit, duke marrë parasysh vlerat kufi të çlirimit nga kolona (ii) të rëndësishme për çdo lëndë djegëse të veçantë, normën e inputit termik të çliruar nga çdo lëndë djegëse dhe, për rafineritë, karakteristikat e rëndësishme specifike të impiantit. Për rafineritë, një vlerë e tillë e kombinuar kufiri në asnjë rrethanë nuk kalon 1,700 mg SO<sub>2</sub>/Nm<sup>3</sup>.

Në veçanti, vlerat kufi nuk zbatohen për impiantet e mëposhtme:

- impiante ku produktet e djegies përdoren për ngrohje, tharje të drejtpërdrejtë ose trajtim tjetër të objekteve ose materialeve, p.sh.: furra ringrohjeje, furra për trajtimin më të nxehtë;
- impiante postdjegies, pra çdo pajisje teknike e përcaktuar që të pastrojë gazet e mbetura nga djegia që nuk funksionon si një impiant i pavarur djegieje;
- ambiente për rigjenerim të katalizatorëve të krisjes;
- ambiente për kthimin e sulfit hidrogjenit në sqfur;
- reaktorë të përdorur në industri kimike;
- furra koksifikimi me bateri;
- perkursorë (Cowpers);
- pajisje për djegie mbeturinash;
- impiante me motorë me gazoil, gazoil (lëndë djegëse) dhe gazi ose nga turbina gazi, pavarësisht lëndës djegëse të përdorur.

Në rastin kur një palë, për shkak të përmbajtjes së lartë të sqfurit të lëndëve djegëse të ngurta apo të lëngshme, nuk mund të arrijë vlerat kufi të çlirimit të përcaktuara në kolonën (ii), mund të zbatohet

normën e desqfurizimit të përcaktuar në kolonën (iii) ose vlerë kufiri maksimal prej 800 mg SO<sub>2</sub>/Nm<sup>3</sup> (edhe pse jo më shumë se 650 mg SO<sub>2</sub>/Nm<sup>3</sup>). Pala raporton çdo zbatim të tillë te Komiteti i Zbatimit në vitin kalendarik kur është bërë. Kur dy ose më shumë impiante të reja të veçanta janë të instaluara, në mënyrë të tillë që duke pasur parasysh faktorët teknikë dhe ekonomikë, gazrat e tyre të mbetura, sipas gjykimit të autoriteteve kompetente mund të shkarkohen përmes një gypi të përbashkët, kombinimi i krijuar nga këto impiante duhet të konsiderohet si një njësi e vetme.

<sup>b)</sup> mg SO<sub>2</sub>/Nm<sup>3</sup> është përcaktuar në temperaturë 273o K dhe trysni 101.3 kPa, pas korrigjimit për përmbajtjen e avullit të ujit.

**LIGJ**  
**Nr.10 437, datë 28.6.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES “PËR KRIJIMIN E AKADEMISË  
NDËRKOMBËTARE ANTIKORRUPSION, SI ORGANIZATË NDËRKOMBËTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja “Për krijimin e Akademisë Ndërkombëtare Antikorrupsion, si organizatë ndërkombëtare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7043, datë 6.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**PËR KRIJIMIN E AKADEMISË NDËRKOMBËTARE ANTIKORRUPSION SI ORGANIZATË**  
**NDËRKOMBËTARE**

Palët,

*duke vërejtur* kontributin e rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), si mbrojtëse e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC);

*duke pranuar* përgatitjet e bëra në nivel ndërkombëtar dhe në veçanti përpjekjet e konsiderueshme të Republikës së Austrisë në bashkëpunim të ngushtë me UNODC-në, si edhe ato të palëve të tjera themeluese për krijimin e Akademisë Ndërkombëtare Antikorrupsion, IACA (në vijim e referuar si “Akademia”) dhe mbështetjen e tyre të fuqishme për Akademinë;

*duke vërejtur* përpjekjet e qëndrueshme dhe mbështetjen e vazhdueshme të Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) për të hartuar dhe zhvilluar nisma për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në mbarë botën;

*duke vërejtur* mbështetjen e konsiderueshme të Zyrës Europiane Antimashtrim (OLAF), si edhe të pjesëmarrësve të tjerë në këtë përpjekje të përbashkët;

*duke theksuar* karakterin global dhe gjithëpërfshirës të kësaj nisme, si edhe rëndësinë e përpjekjeve për diversitetet gjeografik;

*duke njohur* rëndësinë e bashkëpunimit nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta në nivel global dhe rajonal në mbështetje të UNCAC-it, si edhe instrumenteve të tjera përkatëse ndërkombëtare;

*duke ndarë* të njëjtat synime në drejtim të dhënies së asistencës teknike dhe ndërtimit të kapaciteteve si instrumentet kryesore të luftës kundër korrupsionit;

*duke vërejtur* se edukimi, formimi profesional dhe kërkimi antikorrupsion janë komponentë të rëndësishëm të kësaj asistence dhe të ndërtimit të kapaciteteve;

*duke dëshiruar* të intensifikojnë synimet e tyre të përbashkëta nëpërmjet krijimit të Akademisë në bazë të një marrëveshjeje shumëpalëshe të hapur për shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat ndërqeveritare (në vijim të referuara si “Organizatat ndërkombëtare”) dhe duke i ftuar ato të bashkojnë forcat dhe të bëhen palë në këtë Marrëveshje;

*duke iu përgjigjur* ftesës së Republikës së Austrisë për të mirëpritur Akademinë në Laksenburg afër Vjenës.

*kanë rënë dakord* si më poshtë:

#### Neni 1

### **Krijimi dhe statusi**

1. Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje krijohet Akademia si organizatë ndërkombëtare.
2. Akademia ka personalitet të plotë ligjor ndërkombëtar.
3. Ndër të tjera, Akademia ka zotësinë ligjore:
  - a) për të kontraktuar;
  - b) për të blerë dhe shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme;
  - c) për të filluar dhe ndjekur procedime ligjore;
  - d) për të ndërmarrë masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për realizimin e qëllimit dhe veprimtarive të saj.
4. Akademia funksionon në përputhje me këtë Marrëveshje.

#### Neni 2

### **Qëllimi dhe veprimtaritë**

1. Qëllimi i Akademisë është promovimi i parandalimit dhe luftës së efektshme dhe efikase kundër korrupsionit:
  - a) duke siguruar një edukim dhe formim profesional antikorrupsion;
  - b) duke ndërmarrë dhe lehtësuar kërkime në të gjitha aspektet e korrupsionit;
  - c) duke siguruar forma të tjera përkatëse të asistencës teknike në luftën kundër korrupsionit;
  - d) duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe krijimin e rrjeteve në luftën kundër korrupsionit.
2. Veprimtaritë e Akademisë respektojnë parimin e lirisë akademike, plotësojnë standardet më të larta akademike dhe profesionale, si edhe trajtojnë fenomenin e korrupsionit në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore, duke pasur parasysh diversitetin kulturor, barazinë gjinore dhe zhvillimet e fundit në fushën e korrupsionit në nivel global dhe rajonal.

#### Neni 3

### **Selia**

1. Selia e Akademisë ndodhet në Laksenburg, Austri, në bazë të termave dhe kushteve të rëna dakord ndërmjet Akademisë dhe Republikës së Austrisë.
2. Akademia mund të krijojë mjedise në vende të tjera që kërkohen për mbështetjen e veprimtarive të saj.

#### Neni 4

### **Organet**

1. Akademia përbëhet nga:
  - a) Asambleja e palëve, në vijim e referuar si “Asambleja”;
  - b) Bordi i Guvernatorëve, në vijim i referuar si “Bordi”;

- c) Bordi i Lartë Ndërkombëtar Këshillimor;
- d) Bordi Akademik Ndërkombëtar Këshillimor;
- e) Dekani.

#### Neni 5 Asambleja e palëve

1. Asambleja shërben si forum për palët në këtë Marrëveshje për t'u konsultuar në lidhje me politikën e përgjithshme të Akademisë, si edhe për çështje të tjera me interes të parashikuara në këtë Marrëveshje.

2. Asambleja përbëhet nga përfaqësues të palëve. Çdo palë cakton një përfaqësues për të vepruar si anëtar i Asamblesë. Çdo anëtar i Asamblesë ka një votë.

3. Në veçanti, Asambleja:

a) Miraton rekomandime në lidhje me politikën dhe administrimin e Akademisë për shqyrtim nga Bordi;

b) Miraton programin e punës dhe buxhetin e Akademisë të propozuar nga Bordi;

c) Angazhohet në veprimtaritë për sigurimin e fondeve për Akademinë në përputhje me nenin 11;

d) Zgjedh anëtarët e Bordit në përputhje me nenin 6;

e) Merr vendime në lidhje me largimin e anëtarëve të Bordit me një shumicë prej dy të tretash;

f) Rishikon ecurinë e veprimtarive të Akademisë mbi bazën e, ndër të tjera, të raporteve të paraqitura nga Bordi;

g) Miraton marrëveshje ndërkombëtare;

h) Miraton krijimin e mjediseve në vende të tjera.

4. Asambleja mbledhet të paktën një herë në vit dhe i merr vendimet me shumicë të thjeshtë, përveç kur parashikohet ndryshe nga kjo Marrëveshje. Asambleja miraton rregulloren e saj të brendshme dhe zgjedh zyrtarët e saj, duke përfshirë presidentin dhe dy zëvendëspresidentët. Anëtarët e Bordit dhe Dekani mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë pa të drejtë vote.

#### Neni 6 Bordi i guvernatorëve

1. Akademia drejtohet nga një Bord që përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë gjithsej. Nëntë anëtarë zgjidhen nga Asambleja, duke marrë parasysh kualifikimet dhe përvojën e tyre, si edhe parimin e shpërndarjes së barabartë gjeografike. Përveç kësaj, UNODC-ja dhe Republika e Austrisë secila ka të drejtë të emërojë një anëtar. Anëtarët e Bordit shërbejnë në funksionin e tyre individual për një mandat gjashtëvjeçar dhe mund të rizgjidhen apo riemërohen për jo më shumë se një mandat tjetër shtesë. Në zgjedhjen e parë, pesë anëtarë zgjidhen për një periudhë prej vetëm tre vitesh.

2. Në veçanti, Bordi:

a) merr vendime në lidhje me strategjinë, politikën dhe udhëzimet për veprimtaritë e Akademisë;

b) miraton rregullat që rregullojnë funksionimin e Akademisë, duke përfshirë edhe rregulloret financiare dhe rregullat për personelin;

c) emëron Dekanin për një periudhë të rinovueshme katërvjeçare, vlerëson veprimtaritë e tij/saj dhe nëse është e nevojshme ndërmerr largimin e Dekanit;

d) krijon, kur është e nevojshme bordet këshillimore dhe zgjedh anëtarët e tyre;

e) zgjedh anëtarët e Bordit të Lartë Ndërkombëtar Këshillimor dhe Bordit Akademik Ndërkombëtar Këshillimor, duke pasur parasysh kualifikimet dhe përvojën e tyre profesionale, parimin e shpërndarjes së barabartë gjeografike dhe barazinë gjinore;

f) i paraqet për miratim Asamblesë programin e punës dhe buxhetin e Akademisë;

g) emëron një auditues të jashtëm të pavarur;

h) miraton deklaratën vjetore të auditimit të llogarive të Akademisë;

i) i raporton Asamblesë mbi ecurinë e veprimtarive të Akademisë;

j) shqyrton rekomandimet e Asamblesë në lidhje me politikën dhe administrimin e Akademisë;

k) miraton strategjitë dhe udhëzimet për sigurimin e burimeve financiare të Akademisë dhe mbështetet përprjekjet e Dekanit për këtë qëllim;

- l) përcakton kushtet e pranimit të pjesëmarrësve në veprimtaritë akademike të Akademisë;
- m) miraton krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në përputhje me nenin 13;
- n) i paraqet për miratim Asamblesë marrëveshjet ndërkombëtare;
- o) kryen vlerësimin e veprimtarive të Akademisë në bazë të raporteve të paraqitura nga Dekani dhe jep rekomandime në lidhje me këto veprimtari.

3. Bordi mblihet të paktën një herë në vit në selinë e Akademisë dhe i merr vendimet me shumicë të thjeshtë, përveç kur parashikohet ndryshe nga kjo Marrëveshje. Çdo anëtar ka një votë. Bordi miraton rregulloren e tij të brendshme, zgjedh zyrtarët e tij, duke përfshirë kryetarin dhe nënkryetarin, si edhe mund të krijojë komitete, nëse e gjykon të nevojshme, për funksionimin efikas të Akademisë.

#### Neni 7

### **Bordi i Lartë Ndërkombëtar Këshillimor**

1. Bordi këshillohet nga një Bord i Lartë Ndërkombëtar Këshillimor (ISAB), që përbëhet deri në 15 anëtarë, të cilët janë personalitete të shquara me kredenciale të spikatura nga një gamë e gjerë formimesh me rëndësi për veprimtaritë e Akademisë.

2. Funkzioni i Bordit të Lartë Ndërkombëtar Këshillimor është të reflektojë mbi veprimtaritë e Akademisë dhe të ofrojë vërejtje dhe këshilla se si mund të përmbushen dhe ruhen standardet më të larta në drejtim të qëllimit të Akademisë.

3. Anëtarët e Bordit të Lartë Ndërkombëtar Këshillimor shërbejnë në funksionin e tyre individual për një mandat 6-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Në zgjedhjen e parë, shtatë anëtarë zgjidhen për një periudhë prej vetëm tre vitesh.

4. Bordi i Lartë Ndërkombëtar Këshillimor mblihet të paktën një herë në vit dhe i merr vendimet me shumicë të thjeshtë. Çdo anëtar ka një votë. Bordi i Lartë Ndërkombëtar Këshillimor miraton rregulloren e tij të brendshme dhe zgjedh zyrtarët e tij, duke përfshirë kryetarin dhe nënkryetarin.

5. Bordi i Lartë Ndërkombëtar Këshillimor mund t'i rekomandojë Bordit persona që përmbushin kriteret e paragrafit 1 për t'u zgjedhur në Bordin e Lartë Ndërkombëtar Këshillimor.

#### Neni 8

### **Bordi Akademik Ndërkombëtar Këshillimor**

1. Bordi këshillohet në lidhje me çështje mbi edukimin, trajnimin dhe kërkimin nga një Bord Akademik Ndërkombëtar Këshillimor (IAAB), që përbëhet deri në 15 anëtarë, të cilët janë personalitete të shquara akademike apo ekspertë me kualifikimet më të larta në fushat e praktikës, trajnimit dhe kërkimit antikorrupsion dhe/ose drejtësisë penale dhe zbatimit të ligjit që lidhen me antikorrupsionin, si edhe në fusha të tjera të rëndësishme për veprimtaritë e Akademisë.

2. Anëtarët e Bordit Akademik Ndërkombëtar Këshillimor shërbejnë në funksionin e tyre individual për një mandat 6-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Në zgjedhjen e parë, shtatë anëtarë zgjidhen për një periudhë prej vetëm tre vitesh.

3. Bordi Akademik Ndërkombëtar Këshillimor mblihet të paktën një herë në vit dhe i merr vendimet me shumicë të thjeshtë. Çdo anëtar ka një votë. Bordi Akademik Ndërkombëtar Këshillimor miraton rregulloren e tij të brendshme dhe zgjedh zyrtarët e tij, duke përfshirë kryetarin dhe nënkryetarin.

4. Bordi Akademik Ndërkombëtar Këshillimor mund t'i rekomandojë Bordit persona që përmbushin kriteret e paragrafit 1 për t'u zgjedhur në Bordin Akademik Ndërkombëtar Këshillimor.

#### Neni 9

### **Dekani**

1. Dekani është personi përgjegjës për administrimin e përditshëm të Akademisë dhe programin e saj kryesor. Dekani raporton dhe jep llogari para Bordit.

2. Në veçanti, Dekani:

a) përfaqëson Akademinë në marrëdhëniet me jashtë;

b) siguron administrimin e duhur të Akademisë, duke përfshirë burimet njerëzore dhe menaxhimin financiar;

c) harton programin e punës dhe buxhetin e Akademisë për t'u shqyrtuar nga Bordi dhe miratuar nga Asambleja. Programi i punës përfshin prioritetet në fushën kërkimore, veprimtaritë trajnuese, programet mësimore dhe zhvillimin e instrumenteve;

d) zbaton programin e punës dhe buxhetin;

e) i paraqet Bordit raporte vjetore dhe të posaçme mbi veprimtaritë e Akademisë, duke përfshirë edhe deklaratën vjetore të auditimit të llogarive të Akademisë;

f) propozon krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në përputhje me nenin 13 për t'u miratuar nga Bordi;

g) bashkërendon punën e Akademisë me punën e palëve në këtë Marrëveshje, si edhe të institucioneve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, agjencive dhe rrjeteve përkatëse, duke pasur parasysh rekomandimet dhe udhëzimet përkatëse të Asamblesë dhe Bordit, si edhe këshillat e Bordit të Lartë Ndërkombëtar Këshillimor dhe Bordit Akademik Ndërkombëtar Këshillimor;

h) lidh kontrata dhe marrëveshje në emër të Akademisë dhe negocion marrëveshje ndërkombëtare, që do të shqyrtohen nga Bordi dhe miratohen nga Asambleja;

i) kërkon në mënyrë aktive fondet e duhura për Akademinë dhe pranon kontributet vullnetare në emër të Akademisë në përputhje me strategjitë dhe udhëzimet përkatëse të Bordit, si edhe me rregulloret financiare;

j) merr përsipër detyra apo veprimtari të tjera që mund t'i caktohen nga Bordi.

#### Neni 10

##### **Personeli akademik dhe administrativ**

1. Akademia përpiket të rekrutojë dhe mbajë në punë personel akademik dhe administrativ me kualifikimet më të larta të mundshme.

2. Me qëllim arritjen e nivelit më të lartë të efikasitetit dhe efektivitetit ekonomik, Akademia harton një plan dhe lidh marrëveshjet e duhura për personelin akademik me kohë të pjesshme ose të jashtëm dhe i inkurajon shtetet, organizatat ndërkombëtare, universitetet dhe institucionet e tjera përkatëse të shqyrtojnë mbështetjen e pajisjes me personel të Akademisë, duke përfshirë edhe personelin me funksion të përkohshëm.

#### Neni 11

##### **Financimi i Akademisë**

1. Pavarësisht nga synimi afatgjatë për ta bërë Akademinë të pavarur ekonomikisht, burimet e Akademisë përfshijnë si më poshtë:

a) kontributet vullnetare nga palët në këtë Marrëveshje;

b) kontributet vullnetare nga sektori privat dhe donatorë të tjerë;

c) pagesat e shkollimit, tarifatat për trajnimet dhe asistencën teknike, publikimin dhe të ardhura të tjera nga shërbimet;

d) të ardhura që rrjedhin nga këto kontribute, tarifa, përfitime, si edhe të ardhura të tjera, duke përfshirë ato që vijnë nga trustet dhe dhurimet.

2. Viti fiskal i Akademisë është nga 1 janari deri më 31 dhjetor.

3. Llogaritë e Akademisë, në përputhje me rregulloret financiare të miratuara nga Bordi në përputhje me nenin 6 paragrafi 2, nënparagrafi b, u nënshtrohen një auditimi vjetor të jashtëm të pavarur, që duhet të plotësojë standardet më të larta të transparencës, përgjegjshmërisë dhe ligjshmërisë.

4. Palët në këtë Marrëveshje inkurajohen të angazhohen në veprimtaritë për sigurimin e fondeve për Akademinë, duke përfshirë edhe organizimin e konferencave të përbashkëta me donatorë.

#### Neni 12

##### **Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit**

1. Palët në këtë Marrëveshje informojnë njëra-tjetrën dhe konsultohen në lidhje me çështje me interes për bashkëpunimin e tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje, qoftë në mbledhjet e Asamblesë, ose në raste të tjera sipas nevojës.

2. Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe i dokumenteve në bazë të këtij neni, realizohen në përputhje me rregullat e zbatueshme të çdo pale në lidhje me zbulimin e informacionit, dhe u nënshtrohen marrëveshjeve që palët mund të vendosin të lidhin për qëllimet e ruajtjes së fshehtësisë, karakterit të kufizuar dhe sigurisë së informacionit të shkëmbyer. Çdo marrëveshje e tillë vazhdon të zbatohet edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje dhe, për sa i përket një pale të veçantë, edhe pas tërheqjes së asaj pale nga kjo Marrëveshje.

#### Neni 13

#### **Marrëdhëniet e bashkëpunimit**

Akademia mund të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi me shtete, organizata të tjera ndërkombëtare, si edhe me subjekte private apo publike, të cilat mund të kontribuojnë në punën e Akademisë.

#### Neni 14

#### **Privilegjet dhe imunitetet**

1. Akademia, anëtarët e Asamblesë, anëtarët e Bordit, anëtarët e Bordit të Lartë Ndërkombëtar Këshillimor dhe Bordit Akademik Ndërkombëtar Këshillimor, Dekani, personeli dhe ekspertët gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e rëna dakord ndërmjet Akademisë dhe Republikës së Austrisë.

2. Akademia mund të lidhë marrëveshje me shtete të tjera me qëllim sigurimin e privilegjeve dhe imuniteteve të përshtatshme.

#### Neni 15

#### **Përgjegjësia financiare**

Palët në këtë Marrëveshje nuk mbajnë asnjë përgjegjësi individuale apo kolektive për borxhe, detyrime financiare apo detyrime të tjera të Akademisë, për këtë qëllim përfshihet një deklaratë në çdo marrëveshje të lidhur nga Akademia në bazë të nenit 14.

#### Neni 16

#### **Amendimet**

Kjo Marrëveshje mund të amendohet vetëm me pëlqimin e të gjitha palëve në këtë Marrëveshje. Njoftimi për këtë pëlqim bëhet me shkrim te depozitari. Çdo amendim hyn në fuqi pas marrjes nga depozitari të njoftimit të të gjitha palëve në këtë Marrëveshje, ose në një datë tjetër për të cilën palët mund të bien dakord.

#### Neni 17

#### **Dispozitat kalimtare**

1. Palët pranojnë marrëveshjet kalimtare për krijimin dhe funksionimin fillestar të Akademisë që përmban memorandumi në lidhje me krijimin e Akademisë Ndërkombëtare Antikorrupsion në Laksenburg, Austri, i datës 29 janar 2010, dhe bien dakord t'i respektojnë ato derisa organet vendimmarrëse të Akademisë të funksionojnë plotësisht.

2. Çdo vendim që cenon detyrimet e marra përsipër për qëllimin e krijimit dhe funksionimit fillestar të Akademisë apo që krijon detyrime financiare për partnerët (UNODC-ja, shoqata "Miqte e Akademisë" apo Republika e Austrisë) mund të merret vetëm unanimisht nga Bordi.

#### Neni 18

#### **Hyrja në fuqi dhe depozitari**

1. Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara (në vijim të referuara si "Shtetet") dhe organizatat ndërqeveritare (në vijim të referuara si "Organizatat ndërkombëtare") deri më 31 dhjetor 2010. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit.



2. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që nuk e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje mund të aderojnë në të më pas.

3. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit nga tri shtete apo organizata ndërkombëtare.

4. Për çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare që ratifikon, pranon, miraton apo aderon në këtë Marrëveshje pas datës së hyrjes së saj në fuqi, kjo Marrëveshje hyn në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

5. Ministri Federal për Çështjet Europiane dhe Ndërkombëtare të Republikës së Austrisë është depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 19

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Akademisë dhe një pale në këtë Marrëveshje ose ndërmjet palëve në këtë Marrëveshje, në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje apo të ndonjë marrëveshjeje shtesë apo ndonjë çështjeje që cenon Akademinë apo marrëdhëniet mes palëve, e cila nuk është zgjidhur nëpërmjet bisedimeve apo ndonjë forme tjetër zgjidhjeje të rënë dakord më parë, i referohet për një vendim të formës së prerë një gjykate me tre gjyqtarë arbitrazhi: njëri zgjidhet nga secila nga palët në mosmarrëveshje, dhe i treti, i cili është kryetari i gjykatës, zgjidhet nga dy gjyqtarët e parë të arbitrazhit. Në rast se secila nga palët në mosmarrëveshje nuk e ka zgjedhur gjyqtarin e saj të arbitrazhit brenda gjashtë muajve nga caktimi i gjyqtarit të saj të arbitrazhit nga pala tjetër, ose në rast se dy gjyqtarët e parë të arbitrazhit nuk arrijnë të bien dakord në lidhje me të tretin brenda gjashtë muajve nga caktimi i dy gjyqtarëve të parë të arbitrazhit, gjyqtari i dytë apo i tretë i arbitrazhit zgjidhet nga kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e secilës prej palëve në mosmarrëveshje.

#### Neni 20

### **Tërheqja**

1. Secila nga palët në këtë Marrëveshje mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim depozitarin. Kjo tërheqje hyn në fuqi tre muaj pas marrjes së këtij njoftimi nga depozitari.

2. Tërheqja nga kjo Marrëveshje nga një palë në këtë Marrëveshje nuk kufizon, redukton apo përndryshe cenon kontributin e saj, që mund të jetë bërë para datës së hyrjes në fuqi të tërheqjes nga Marrëveshja.

#### Neni 21

### **Përfundimi**

1. Palët në këtë Marrëveshje, duke vepruar unanimisht, mund t'i japin fund kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë dhe ta mbyllin Akademinë duke njoftuar me shkrim depozitarin. Të gjitha asetet e Akademisë që mbeten pas shlyerjes së detyrimeve të saj ligjore shiten në përputhje me një vendim unanim të Asamblesë.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje vazhdojnë të jenë të zbatueshme pas përfundimit të saj deri në masën e nevojshme për të lejuar shitjen e rregullt të aseteve dhe shlyerjen e llogarive.

Bërë në Vjenë më ..... në gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 10.7.2011  
Doli nga shtypi më 12.7.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 44 lekë